

**GJYKATA E RRETHIT
TIRANE**

Nr. 12825 Aktit

12825

Tirane, me/6 Nentor 1995

**VENDIM
I GJYQTARIT TE VETEM
PER REGJISTRIM PERSONI JURIDIK**

Sot, me date/6 Nentor 1995, une *J. Tepu* gjyqtare prane kesaj gjykate, pasi studjova kerkesen dhe materialet e tjera te paraqitura nga Administratori i Deges se Shoqerise ALFA CREDIT BANK A.E.(S.A.), me seli ne Athine, Greqi, George Diamantopulous, ne emer te saj per regjistrimin e nje dege te saj si person juridik ne Regjistrin Tregtar

KONSTATOVA SE:

Shoqeria Alfa Credit Bank A.E.(S.A.) eshte themeluar si person juridik me 10 mars te vitit 1918 dhe eshte regjistruar ne Ministrine Greke te Tregtise me numer amze 6066/06/B/05.

Shoqeria nuk ka falimentuar dhe as eshte vene ne gjendje likuidimi dhe se ndaj saj nuk eshte depozituar ndonje kerkese per ta vene ne administrim te detyruar;

Ne statutin e saj shoqeria meme parashikon se mund te cele dege ne vende te ndryshme dhe, me date 21 Shtator 1995 Keshilli Drejtues ka vendosur te cele nje dege te shoqerise ne Tirane, Shqiperi, duke iu permbajtur kerkesave te ligjit shqiptar "Per Shoqerite Tregtare".

Emertimi i deges do te jete ALFA CREDIT BANK-Tirana Branch.

Selia e deges do te jete ne Bulevardin "Deshmoret e Kombit" N.47, Tirane.

Kapitali fillestar i Deges eshte 2(dy)milion leke dhe eshte nenshkruar teresisht.

Dega do te kryeje te gjitha operacionet bankare qe parashikohen ne nenin 4 te Statutit te Shoqerise meme dhe te cdo lloj tjeter veprimtarie qe parashikohet dhe lejohet nga legjislacioni shqiptar.

Administrimi i deges ne Shqiperi i eshte ngarkuar z.George Anastasios Diamantopulous.

Kohezgjatja eshte e pacaktuar.

Kerkesa per regjistrimin e deges si person juridik ne Regjistrin Tregtar eshte e mbeshtetur ne ligj dhe

PER KETO ARSYE,

une gjyqtarja, ne baze te ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare"

VENDOSA:

1. Urdherohet zyra e Regjistrit Tregtar te regjistroje degen e shoqerise Alfa Credit Bank A.E.(S.A.), si person juridik ne Regjistrin Tregtar.

Selia e deges do te jete ne Bulevardin "Deshmoret e Kombit" N.47, Tirane,

Administrator per degen do te jete z.George Anastasios Diamantopoulos.

Kohezgjatja do te jete e pacaktuar.

Kapitali fillestar i Deges eshte 2(dy)milion leke dhe eshte nenshkruar teresisht.

Dega do te kryeje te gjitha operacionet bankare qe parashikohen nga neni 4 i Statutit dhe cdo lloj tjeter veprimtarie me interes per shoqerine e qe lejohet nga legjislacioni shqiptar.

2.Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne gjykatën e Apelit.

GJYQTARE

(*Flora Tegu*)
1992

GJYKATA E RRETHIT

TIRANE

Nr. 12825/1 Akt

Tirane, me Janar 1996

**VENDIM
PER DEPOZITIM AKTESH PERSONI JURIDIK**

Sot, me date 25 Janar 1996, une *Stavros Tepi*, gjyqtare prane kesaj gjykate, pasi studjova materialet e paraqitura nga Administratori i deges se shoqerise "Alpha Credit Bank" A.E., z. George Diamantopoulos, per depozitimit te konfermes se leshuar nga Banka e Shqiperise per depozitimin prane kesaj te fundit te mbi 1/4 pjese te kapitalit, pra 56.334.000 (pesedhjetegjashtemilion e treqindetridhjetekatermije) leke, te kerkuar per te vepruar si Banke ne Republiken e Shqiperise.

KONSTATOVA:

Se dega e shoqerise "Alpha Credit Bank" A.E. eshte krijuar me vendim te Keshillit Drejtues te dates 21 Shtator 1995 dhe ka fituar personalitetin juridik me vendimin n.12825 te dates 16 nentor 1995 te Gjykates se Rrethit Tirane.

Shoqeria meme, ne baze te Vendimit te Keshillit Drejtues e financon Degen ne Shqiperi ne shumen 200.000.000 (dyqindmilion) leke dhe per kete qellim ka paguar prane Bankes se Shqiperise, per llogari te Deges se saj ne Shqiperi, shumen prej 56.334.000 (pesedhjetegjashtemilion e treqindetridhjetekatermije) leke, qe perben mbi 1/4 pjese te kapitalit te deges.

Pagesa eshte realizuar me date 29 Nentor 1995 dhe vertetohet me konfermen e leshuar nga Banka e Shqiperise me date 18.1.1996.

Kerkuesi kerkon pasqyrimin e ketij depozitimi ne skeden perkatese te Deges ne Regjistrin Tregtar.

Duke shqyrtuar kerkesen dhe aktin qe verteton pagesen e mbi 1/4 pjese te kapitalit themeltar, leshuar nga Banka Shqiperise ne baze te ligjit 7667, date 28.1.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare" e konsideroj te mbeshtetur,

**DHE PER KETE ARSYE
VENDOSA:**

Depozitimin ne Zyren e Regjistrit Tregtar te konfermes se Bankes se Shqiperise qe verteton se Shoqeria "Alpha Credit Bank" A.E. ka depozituar, per llogari te Deges se saj ne Shqiperi, shumen 56.334.000 (pesedhjetegjashtemilion e treqindetridhjetekatermije) leke, qe perben mbi 1/4 pjese te Kapitalit prej 200.000.000 (dyqindmilion) leke, qe financohesh nga shoqeria meme ne

baze te vendimit te Keshillit Drejtues te saj e qe kerkohet per te vepruar si Banke ne Republiken e Shqiperise, duke u bere shenimi perkates ne kolonen 4 dhe 5 te fletes se regjistrit me numrin rendor 2.

Te behet ndarja e regjistrimeve nga njeri tjetri me vije te kuqe.

Gjyqtare

Ilona Teta
9.8.2008

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Nr. _____Akt

VENDIM
I GJYQTARIT TE VETEM
PER DEPOZITIM AKTESH TE PERSONIT JURIDIK

Sot, me date 24 tetor 1997, une *J. Xho Xho* gjyqtare prane kesaj gjykate, pasi studjova kerkesen dhe Vendimin e Bordit te Bankes Alpha Credit A.E., te dates 16 Shtator 1997, paraqitur nga Avokati Perparim Kalo, autorizuar nga kjo mbledhje per te kryer procedurat e duhura

KONSTATOVA:

Se Shoqeria "ALPHA CREDIT BANK A.E.", me seli ne Athine, ka celur nje dege te saj me vendimin e Bordit Drejtues te saj date 21 Shtator 1995.

Dega eshte regjistruar ne Regjistrin Tregtar me vendimin N.12825, date 16 Nentor 1995 te kesaj Gjykate me Drejtor te saj ne Shqiperi z. George Diamantopoulos.

Mbledhja e dates 16 Shtator 1997 e Bordit Drejtues i Bankes ka vendosur te beje zevendesimin e z. George Diamantopoulos me z.Andreas Bartzis, shtetas grek, i datelindjes 1950, banues ne Krines, Korinth.

Perfaqesuesi kerkon qe ky ndryshim te pasqyrohet ne Regjistrin Tregtar nepermjet depozitimit te Vendimit ne skeden perkatese te Deges Shoqerise.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit Nr 7667 date 28.01.1993 Per Regjistrin Tregtar dhe Formalitet qe duhen Respektuar nga Shoqerite Tregtare

VENDOSA:

Depozitimin e Vendimit te Bordit Drejtues te Bankes Alpha Credit A.E. te dates 16 Shtator 1997 qe ka bere emerimin e Drejtorit te ri te Deges se saj ne Shqiperi, z.Andreas Bartzis, shtetas grek, i datelindjes 1950 ne skeden perkatese te kesaj shoqerie ne Regjistrin Tregtar.

Gjyqtare
Alti Xho Xho

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Nr. ~~12825~~ / Akt

6345

VENDIM I GJYQTARIT TE VETEM
PER DEPOZITIMIN E AKTEVE TE PERSONIT JURIDIK

Sot, me date 26.01. 1999, une Denise Cof, gjyqtare prane kesaj gjykate, pasi studjova kerkesen dhe dokumentet e tjera te paraqitura nga perfaqesuesi i autorizuar i Shoqerise "ALPHA CREDIT BANK-Tirana Branch" Sh.a.. Z. Perparim Kalo per depozitimin e akteve te personit juridik ne lidhje me korigjimin e emertimit te shoqerise ALPHA CREDIT BANK-Tirana Branch" Sh.a.

KONSTATOVA SE :

Shoqeria "ALPHA CREDIT BANK- Tirana Branch" Sh.a., eshte regjistruar si person juridik me Nr. Vendimi 12825, date 16.11.1995 te Gjykates se Rrethit Tirane me ortak: Shoqerine "Alpha Credit Bank" A.E.(S.A) themeluar si person juridik ne 10 Mars 1918 dhe eshte rregjistruar ne Ministrine Greke te Tregtise me Nr. Amze 6066/06/B/05, me Drejtor te Pergjithshem z. Andreas Bartzis.

Ne vendimin qe ka marre Gjykata e Rrethit Tirane per Rregjistrimin si person juridik te shoqerise "ALPHA CREDIT BANK- Tirana Branch" Sh.a. eshte shtypur gabim emertimi i Shoqerise qe rregjistrohej. Ne vendimin e rregjistrimit fjala "ALPHA" eshte shkruar gabimisht "ALFA" dhe meqenese nga Banka e Shqiperise i eshte kerkuar kesaj shoqerie qe te beje korigjimin e ketij gabimi te pasqyruar ne Vendimin e Rregjistrimit te Shoqerise, kerkuesi i eshte drejtuar Gjykates duke i kerkuar korigjimin e ketij gabimi dhe duke sjelle provat perkatese qe evidentojne kete korigjim.

PER KETO ARSYE:

Pas shqyrtimit te kerkeses, e cmoj ate te mbeshtetur ne ligjin Nr. 7638, 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", dhe te nenit 17 Ligjit Nr. 7667, date 28.01.1993, "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare"

VENDOSA

- Te bej korigjimin e vendimit te Rregjistrimit te Shoqerise "ALPHA CREDIT BANK-Tirana Branch" ne lidhje me emertimin e Shoqerise i cili do te korigjohet si me poshte : Nga "ALFA CREDIT BANK- Tirana Branch" Sh.a. qe paraqitet ne vendimin e rregjistrimit do te korigjohet ne "ALPHA CREDIT BANK-Tirana Branch" Sh.a.

- Urdherohet Zyra e Regjistrin Tregtar te beje pasqyrimin e ndryshimeve ne skeden perkatese te shoqerise.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit

Gjyqtare

Denise Cof



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Nr. ~~12895/4~~ Akt

12825/4

VENDIM I GJYQTARIT TE VETEM
PER DEPOZITIMIN E AKTEVE TE PERSONIT JURIDIK

Sot, me date 1 Prill 1999, une Altina Xhoxhaj, gjyqtare prane kesaj gjykate, pasi studjova kerkesen dhe dokumentet e tjera te paraqitura nga perfaqesuesi i autorizuar i Shoqerise "ALPHA CREDIT BANK-Tirana Branch" Sh.a.. Z. Perparim Kalo per depozitimin e akteve te personit juridik ne lidhje me shoqerine ALPHA CREDIT BANK-Tirana Branch" Sh.a.

KONSTATOVA SE :

Shoqeria "ALPHA CREDIT BANK- Tirana Branch" Sh.a., eshte regjistruar si person juridik me Nr. Vendimi 12825, date 16.11.1995 te Gjykates se Rrethit Tirane me ortake: Shoqerine "Alpha Credit Bank" A.E.(S.A) themeluar si person juridik ne 10 Mars 1918 dhe eshte rregjistruar ne Ministrine Greke te Tregtise me Nr. Amze 6066/06/B/05, me Drejtor te Pergjithshem z. Andreas Bartzis.

Ne daten 18 Shtator 1997, Keshilli i Drejtuesve i shoqerise meme ka marre vendim ndermjet te tjerash te financoje degen e saj ne Tirane ne shumen 350.000.000 (treqindepesdhjetmilion) leke ose 2.500.000 USD e cila eshte derdhur fillimisht ne Banken e Shqiperise dhe me pas marrjes se licences nga kjo banke i eshte kthyer ALPHA CREDIT BANK DEGA SHQIPERI dhe do te jete pjese e kapitalit te shoqerise.

PER KETO ARSYE:

Pas shqyrtimit te kerkeses, e cmoj ate te mbeshtetur ne ligjin Nr. 7638, 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe Ligjit Nr. 7667, date 28.01.1993, "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare"

VENDOSA


- Pranimin e kerkeses

- Depozitimin e Vendimt te Keshillit te Drejtuesve te dates 18 Shtator 1997 te "ALPHA CREDIT BANK", AE qe ka marre vendim per te financiar degen e saj me 350.000.000 leke (Treqindepesdhjetmilion) ose 2.500.000 USD (Dymilionepeseqindmije) dollare amerikane.

- Urdherohet Zyra e Regjistrin Tregtar te beje pasqyrimin e ndryshimeve ne skeden perkatese te shoqerise dhe konkretisht ne kolonat 4 dhe 5 pika c

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit

Gjyqtare



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 12825/ 5Akt

125

VENDIM I GJYQTARIT TE VETEM
PER DEPOZITIM AKTESH TE PERSONIT JURIDIK

Sot, me date 30 Shtator 1999, une Leqina Seloku gjyqtare prane kesaj gjykate, pasi studjova kerkesen dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtori i Bankes "Alpha Credit Bank-Tirana Branch" Sh.a.Andreas Bartzis, per depozitimin e akteve te personit juridik ne lidhje me shoqerine ALPHA CREDIT BANK-Tirana Branch

KONSTATOVA SE:

Shoqeria "ALPHA CREDIT BANK-Tirana Branch"Sh.a. eshte regjistruar si person juridik me Nr. Vendimi 12825 date 16.11.1995 te Gjykates se Rrethit Tirane me ortake : Shoqerine "Alpha Credit Bank" A.E (S.A) themeluar si person juridik ne 10 Mars 1918 dhe eshte regjistruar ne Ministrine Greke te Tregtise me Nr. Amze 6066/06/B/05, me Drejtor te Pergjithshem z. Andrea Bartzis.

Ne daten 24.09.1999, Keshilli Drejtues i Shoqerise meme ka marre vendim, ndermjet te tjerash, te rrise kapitalin e deges ne Shqiperi qe aktualisht eshte 350.000.000 qe I korrespondojne 2.580.000 dollare amerikane ne 700.000.000 (shtateqindmilion) leke qe I korrespondojne 5.160.000 (pesemilion e njeqind e fjashtedhete mije) dollare amerikane.

Rritja e kapitalit do te kryhet menjehere duke derdhur ne Banken e Shqiperise brenda dates 30 Shtator 1999, shumen 350.000.000 qe i korrespondojne dhe kapitali i shoqerise do te arrije shumen 700.000.000 (shtateqind milion) leke. Ne kete menyre Dega e Shoqerise, ploteson kushtin e vendosur nga Banka e Shqiperise qe brenda dates 30 Shtator 1999, te kete rritur kapitalin e saj ne shumen 500.000.000 leke duke e rritur ate mbi kete shume te kerkuar, pra duke e cuar ne shumen 700.000.000 leke.

PER KETO ARSYE:

Pas shqyrtimit te kerkeses, e cmoj ate te mbeshtetur ne ligj Nr. 7638, 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare dhe Ligjin Nr. 7667 date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare"

VENDOSA:

-Pranimin e Kerkeses

- Depozitim e Vendimit te Keshillit Drejtues te dates 24.09.1999 te "ALPHA CREDIT BANK" AE qe ka marre vendim per te rritur kapitalin e deges se saj ne Tirane nga 350.000.000leke(treqindepesdhjetmilion) qe eshte aktualisht ne 700.000.000 leke (shtateqinmilion)

Urdherohet zyra e Regjistrit Tregtar te beje pasqyrimin e ndryshimeve ne skeden perkatese te shoqerise dhe konkretisht ne kolonat 4 dhe 5 pika c

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit

GJYQTARE

Fajza Vllahu
Abdullahu

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Nr. 12825/6

VENDIM I GJYQTARIT TE VETEM

Sot, me date 28 Prill 2000, une Imzime Dllahu gjyqtare prane kesaj gjykate, pasi studiova kerkesen dhe dokumentet e paraqituara nga z. Andreas Bartzis, drejtor i Pergjithshem i shoqerise "ALPHA CREDIT BANK – Tirana Branch" Sh.a., per depozitimim aktesh te personit juridik,

KONSTATOVA SE:

Shoqeria "ALPHA CREDIT BANK – Tirana Branch" Sh.a., eshte regjistruar si person juridik me Vendim te Gjykates se rrethit Tirane Nr. 12825, date 16 Nentor 1995, me ortake te vetme: Shoqerine "ALPHA CREDIT BANK" A.E. (Sh.A) themeluar si person juridik me 10 Mars 1918 dhe regjistruar ne Ministrine Greke te Tregtise me nr. Amze 6066/06/B/05; me seli ne Bulevardi "Deshmoret e Kombit, nr. 47/1, Tirane; me Drejtor te Pergjithshem z. Andreas Bartzis.

Me vendim te Gjykates se rrethit Tirane nr. 12825/5, Akti nr. 7125, date 30 Shtator 1999 eshte pranuar dhe depozituar Vendimi i Keshillit Drejtues se dates 24.09.1999 te "ALPHA CREDIT BANK" A.E., sipas te cilit eshte bere zmadhimi i kapitalit te shoqerise me nje shtese prej 2.580.000 (dy milione e peseqind e tetedhjete mije) dollare Amerikane. Deri ne marrjen e ketij vendimi kapitali i shoqerise ishte 2.500.000 (dy milione e peseqind mije) dollare Amerikane dhe me kete shtese ai arrin vleren prej **5.080.000 (pese milione e tetedhjete mije) dollare Amerikane**. Ky zmadhim kapitali eshte realizuar duke derdhur ne Banken e Shqiperise shumen prej 2.580.000 (dy milione e peseqind e tetedhjete mije) dollare Amerikane. Kjo derdhje vertetohet me Vertetimin e leshuar nga Departamenti i Mbikeqyrjes se Bankes se Shqiperise me date 06 Tetor 1999, Prot. Nr. 6. Ne baze te ketij Vertetimi, duke bere konvertimin, e vleres totale te kapitalit te shoqerise, ne dollare me kursin e kembimit te dollarit Amerikan kundrejt Lekut (kursi mesatar ditor 1USD=134.40 Leke) te dates 29 Shtator 1999, del se vlere e kapitalit te paguar te shoqerise "ALPHA CREDIT BANK –Tirana Branch" Sh.a., eshte **682.752.000 (gjashteqind e tetedhjete e dy milione e shtateqind e pesedhjete e dy mije) Leke**.

PER KETO ARSYE:

Pas shqyrtimit te kerkeses, e cmoj ate te mbeshtetur ne Ligjin nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ne Ligjin nr. 7667, date 28.01.1999 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare",

VENDOSA:

- Pranimin e kerkeses
- Depozitimin e Vertetimit te leshuar nga Departamenti i Mbiqyrjes se Bankes se Shqiperise Prot. Nr. 6, date 06 Tetor 1999. Bazuar ne kete vertetim del se, shuma e kapitalit te paguar te shoqerise "ALPHA CREDIT BANK – Tirana Branch" Sh.a. eshte **5.080.000 (pese milione e tetedhete mije) dollare Amerikane** dhe e konvertuar ne leke eshte **682.752.000 (gjashteqind e tetedhete e dy milione e shtateqind e pesedhete e dy mije) Leke.**

Urdherohet Zyra e Regjistrimit Tregtar te beje pasqyrimin e ndryshimeve ne skeden perkatese te shoqerise "ALPHA CREDIT BANK – Tirana Branch" Sh.a..


Kunder ketij vendimi mund te behet ankimi ne Gjykatën e Apelit Tirane.

GJYQTARE

Regjistrimi Tregtar
Shqiperise

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Nr. 12825/6



VENDIM I GJYQTARIT TE VETEM

Sot, me date 15 Shtator 2000, une Ilirida Cops gjyqtare prane kesaj gjykate, pasi studiova kerkesen dhe dokumentet e paraqitura nga z. Andreas Bartzis, drejtor i Pergjithshem i shoqerise "ALPHA BANK A.E. - Tirana Branch", per depozitimim aktesh te personit juridik,

KONSTATOVA SE:

Shoqeria "ALPHA BANK A. E. - Tirana Branch" Sh.a., eshte regjistruar si person juridik me Vendim te Gjykates se rrethit Tirane Nr. 12825, date 16 Nentor 1995, me ortake te vetme: Shoqerine "ALPHA BANK" A.E. themeluar si person juridik me 10 Mars 1918 dhe regjistruar ne Ministrine Greke te Tregtise me nr. Amze 6066/06/B/05; me seli ne Bulevardi "ZOGU I", nr. 47/1, Tirane; me Drejtor te Pergjithshem z. Andreas Bartzis dhe me kapital te paguar 5.080.000 USD (pese milione e tetedhjete mije Dollare Amerikane) ose i konvertuar ne leke eshte 682.752.000 (gjashteqind e tetedhjete e dy milione e shtateqind e pesedhjete e dy mije) Leke.

Me vendim te Keshillit Drejtues te "ALPHA BANK A. E.", date 01 Gusht 2000, eshte vendosur te behet zmadhimi i kapitalit te shoqerise. Keshtu kapitali i shoqerise nga shuma 5.080.000 USD (pese milione e tetedhjete mije Dollare Amerikane) do te zmadhohet duke shtuar shumen prej **5.000.000 USD (pese milion Dollare Amerikane)**.

Keshtu kapitali i shoqerise do te arrije ne shumen **10.080.000 USD (dhjete milion e tetedhjete mije Dollare Amerikane) ose i konvertuar ne Leke 1.431.964.800 (nje miliard katerqindetridhjeteeenje milion nenteqindegjashtedhjeteeater mije e teteqind)**.

Shtesa e kapitalit ne shumen e mesiperme prej **5.000.000 USD (pese milion Dollare Amerikane)** eshte derdhur direkt ne Banken "ALPHA BANK A. E. - Tirana Branch" Sh.a., me date 2 Gusht 2000 sipas konfirmimit te leshuar prej saj Prot. No. 1049/1, date 2 Gusht 2000.

PER KETO ARSYE:

Pas shqyrtimit te kerkeses, e cmoj ate te mbeshtetur ne Ligjin nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe ne Ligjin nr. 7667, date 28.01.1999 "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare",



VENDOSA:

- Pranimin e kerkeses
- Depozitimn e Vendimit te Keshillit Drejtues te ALPHA BANK A. E., date 01 Gusht 2000, sipas te cilit kapitali i shoqerise "ALPHA BANK" A.E.- Tirana Branch., nga shuma prej 5.080.000 (pese milione e tetedhete mije Dollare Amerikane) eshte zmadhuar me shumen prej **5.000.000.USD (pese milion Dollare Amerikane)**.
Keshtu kapitali i shoqerise do te arrije ne shumen **10.080.000 USD (dhjete milion e tetedhete mije Dollare Amerikane)** ose i konvertuar ne Leke **1.431.964.800 (nje miliard katerqindetridhjetee mije milion nenteqindegjashtedhjetee kater mije e teteqind)**.

Urdherohet Zyra e Regjistrimit Tregtar te beje pasqyrimin e ndryshimeve ne skeden perkatese te shoqerise "ALPHA BANK A.E. – Tirana Branch.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Nr. 12825A

VENDIM I GJYQTARIT TE VETEM

Sot, me date 19.6 Qershor 2000, une M. Dajç gjyqtare prane kesaj gjykate, pasi studiova kerkesen dhe dokumentet e paraqituara nga z. Andreas Bartzis, drejtor i Pergjithshem i shoqerise "ALPHA BANK A.E. – Tirana Branch", per depozitimim aktesh te personit juridik,

KONSTATOVA SE:

Shoqeria "ALPHA CREDIT BANK – Tirana Branch" Sh.a., eshte regjistruar si person juridik me Vendim te Gjykates se rrethit Tirane Nr. 12825, date 16 Nentor 1995, me ortake te vetme: Shoqerine "ALPHA CREDIT BANK" A.E. (ose ALFA TRAPEZA PISTEOS A.E.) themeluar si person juridik me 10 Mars 1918 dhe regjistruar ne Ministrine Greke te Tregtise me nr. Amze 6066/06/B/05; me seli ne Bulevardi "Deshmoret e Kombit, nr. 47/1, Tirane; me Drejtor te Pergjithshem z. Andreas Bartzis dhe me kapital te paguar 5.080.000 (pese milione e tetedhete mije) dollare Amerikane ose i konvertuar ne leke eshte 682.752.000 (gjashteqind e tetedhete e dy milione e shtateqind e pesedhete e dy mije) Leke.

Me vendim te Mbledhjes se pergjithshme te Aksionereve te "ALFA TRAPEZA PISTEOS" A.E., te dates 28 Mars 2000, eshte vendosur ndryshimi i nenit 1 te Statutit te shoqerise, me ane te te cilit behet ndryshimi i emrit te saj. Keshtu, neni 1 i Statutit do te kete kete permbajtje:

"NENI 1.

Krijohet shoqeria anonime bankare nen emertimin "ALFA TRAPEZA ANONIMOS ETERIA" ku ALFA mund te shkruhet latinisht "ALPHA", domethene "ALPHA TPAPEZA ANONIMOS ETERIA " dhe ne gjuhe te huaj "ALPHA BANK A.E " dhe titull te shkurtuar " ALFA BANK " ose ALPHA BANK."

Me Vendim Zv/Ministrit te Zhvillimit te Greqise, Nr.Protokolli: k2 – 5643, date 10 Maj 2000, eshte vendosur miratimi i ndryshimit te nenit 1 te Statutit te shoqerise anonime "ALFA TRAPEZA PISTEOS" A.E., me numer amze 6066/06/B/86/05, sipas Vendimit te dates 28 Mars 2000, te Asamblese se Aksionereve te saj. Po me kete date eshte bere regjistrimi i ketij Vendimi ne Amzen e Shoqerive Anonime. Gjithashtu, me nje Njoftim te leshuar ne kete date nga Sekretaria e Pergjithshme e Tregtise, Drejtoria e Pergjithshme e Tregtise se Brendshme, Drejtoria e Shoqerive Anonime e te Kreditit,

Sektori B', prane Ministrise se Zhvillimit se Republikes se Greqise, eshte bere publikimi ne Gazeten Zyrtare ne volumn e shoqerive anonime dhe me pergjegjesi te kufizuar i ndryshimit te emrit te shoqerise anonime "ALPHA TRAPEZA PISTEOS" A.E.

Bazuar ne aktet e mesiperme, behet edhe ndryshimi i emrit te deges ne Tirane te shoqerise "ALPHA CREDIT BANK" A.E. nga emertimi i meparshem "ALPHA CREDIT BANK A.E." – Tirana Branch ne emertimin e ri "ALPHA BANK" A.E.- Tirana Branch.

PER KETO ARSYE:

Pas shqyrtimit te kerkeses, e cmoj ate te mbeshtetur ne Ligjin nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ne Ligjin nr. 7667, date 28.01.1999 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare",

VENDOSA:

- Pranimin e kerkeses
- Depozitimn e akteve te mesiperme te shoqerise meme "ALPHA BANK" A.E., per ndryshimin e emrit te deges se saj ne Tirane nga emertimi i meparshem "ALPHA CREDIT BANK A.E." – Tirana Branch ne emertimin e ri "ALPHA BANK" A.E.- Tirana Branch.

Urdherohet Zyra e Regjistrin Tregtar te beje pasqyrimin e ndryshimeve ne skeden perkatese te shoqerise "ALPHA BANK A.E. – Tirana Branch.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane.

GJYQTARE
Majlinda Loff
ALP

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TIRANË
Nr. 12825/9

VENDIM I GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë 20 Maj 2002, unë Juliana Cafa gjyqtare pranë kësaj gjykate, pasi studiova kërkesën dhe dokumentet e paraqitura nga z. Andreas Galatoulas, Drejtor i shoqërisë “**ALPHA BANK A.E. – Tirana Branch**”, për depozitim aktesh te personit juridik,

KONSTATOVA SE:

Shoqëria “ALPHA BANK A. E. – Tirana Branch”, është regjistruar si person juridik me Vendim të Gjykatës së rrethit Tiranë Nr. 12825, datë 16 Nëntor 1995, me ortake të vetme: Shoqërinë “ALPHA BANK” A.E., themeluar si person juridik më 10 Mars 1918 dhe regjistruar në Ministrinë Greke të Tregtisë me nr. Amze 6066/06/B/05; me seli në Bulevardi “Zog I”, nr. 47/1, Tiranë; me kapital të paguar 10.080.000 USD (dhjetë milion e tetëdhjetë mijë Dollarë Amerikane) ose i konvertuar në Lekë është 1.431.964.800 (një miliard katërqind tridhjetë e një milion nëntëqind gjashtëdhjetë e katër mijë e tetëqind).

Me vendimin e Këshillit Drejtues të “ALPHA BANK A. E.”, të datës 21 Mars 2002, është vendosur që **Z. Andreas Antonios Galatoulas** (mbajtës i pasaportës Greke nr. N 830439) të caktohet Drejtor i Degës së Tiranës. Sipas këtij Vendimi, Drejtorit të ri i jepen tagrat dhe kompetencat e mëposhtme:

- të përfaqësojë dhe të angazhojë Bankën, gjatë kryerjes së transaksioneve bankare, brenda kuadrit rregullator të Bankës dhe të autoriteteve përkatëse të shtetit shqiptar;
- të përfaqësojë Bankën përpara Bankës së Shqipërisë dhe përpara cdo autoriteti tjetër bankar, gjyqësor, rregullues, policor, etj.;
- t’u drejtojë dhe të nënshkruajë shkresa të cdo natyre, autoriteteve të mësipërme, të pranojë cdo lloj shkrese drejtuar Bankës, dhe në përgjithësi të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshme për licensimin e degëve të Bankës në Shqipëri nga autoritetet përkatëse si dhe, për funksionimin e Degëve të saj në këtë vend, etj..

Kërkesa për depozitim aktesh është e drejtë dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE:

Pas shqyrtimit të kërkesës, e cmoj atë të mbështetur në Ligjin nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare” dhe në Ligjin nr. 7667, datë 28.01.1999 “Për Regjistrin Tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare”, dhe


VENDOSA:

- Pranimin e kërkesës
- Depozitimim e Vendimit të Këshillit Drejtues të ALPHA BANK A. E., të datës 21 Mars 2002, me të cilin është vendosur që **Z. Andreas Antonios Galatoulas** (mbajtës i pasaportes Greke nr. N 830439) të caktohet **Drejtore i shoqërisë "ALPHA BANK A.E. – Tirana Branch"**.

Urdhërohet Zyra e Regjistrimit Tregtar të bëjë pasqyrimin e ndryshimeve në skedën përkatëse të shoqërisë "ALPHA BANK A.E. – Tirana Branch".

Kundër këtij vendimi lejohet ankim në shkallë të dytë.

G J Y Q T A R E



A handwritten signature in black ink, appearing to read "Andreas Galatoulas", is written over a horizontal line. Below the line, there is a large, stylized flourish or mark.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE
TIRANE

Nr 12827 Vendimit

V E N D I M
I G J Y Q T A R I T T E V E T E M

Sot, me date 30.06.2005, une gjyqtarja A. C. C.
prane Gjykates te Shkalles se Pare Tirane pasi shqyrtova kerkesen e paraqitur nga
kerkuesi **Orfea DHUCI**, per nje ndryshim ne Kapitalin Themeltar te Shoqerise **Alpha
BANK A.E. Tirana Branch**:

K O N S T A T O V A

Me vendimin Nr. 12525 date 16.11.1995, te Gjykates se Rrethit Tirane eshte
regjistruar Shoqeria **Alpha BANK A.E. Tirana Branch**, me seli ne Bul. "Zog I", Nr.
47, Tirane, me Kapital Themeltar _____.

Shoqeria **Alpha BANK A.E. Tirana Branch** gjate periudhes se punes qe nga
momenti i krijimit ka zgjeruar aktivitetin e saj, duke menduar ta rris kapitalin e saj.
Per kete me vendimin e Keshillit Drejtues se Shoqerise **Alpha BANK A.E.** date
13.04.2005 eshte vendosur rritja e kapitalit themeltar te shoqerise **Alpha BANK A.E.
Tirana Branch** nepermjet kapitalizimit te fitimeve te viteve ushtrimore te meparshme
te Deges se Tiranës ne shumen prej **9.371.576 EURO**.

Depozitimim e dokumentacionit te nevojshem prane Rregjistrin Tregetar te Gjykates se
Shkalles se Pare Tirane per te bere ndryshimet e nevojshme ne Regjistrin perkates.

Kerkesa eshte e drejte, e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet pranuar.

P E R K E T O A R S Y E

Ne baze te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqeri Tregtare "dhe Ligjit,
Nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregetar"

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.

Depozitimim ne regjistrin tregtar te vendimit te Keshillit Drejtues se Shoqerise
Alpha BANK A.E. date 13.04.2005 per Shoqerine **Alpha BANK A.E. Tirana Branch**

Shenimin ne fleten perkatese ne kolonen

Rregjistrimet te behen me Nr. _____ rendor, duke u ndare nga njeri tjetri me vije te
kuqe

G J Y Q T A R E

Aris me C. C.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

Nr. _____ Vendimi

12825/11

VENDIM
I GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë *17/10/07* 2007, unë *R. Pona* gjyqtare pranë kësaj gjykate, pasi studiova kërkesën dhe dokumentet e paraqitura nga "ALPHA BANK A.E. Tirana Branch", për depozitim aktesh të personit juridik,

KONSTATOVA SE:

"ALPHA BANK A.E.-Tirana Branch", është regjistruar në Regjistrin Tregtar me Vendimin nr. 12825, datë 16 Nëntor 1995, të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe mban Licensë Nr. 10, datë 07.01.1998, lëshuar nga Banka e Shqipërisë për të vepruar si Bankë në territorin e Republikës së Shqipërisë, me seli në Bulevardi "Zog I", Nr. 47, Tiranë, Shqipëri.


Më datë 27 Korrik 2006, në bazë të Nenit 5, paragrafi B, të Statutit të shoqërisë, Këshilli Drejtues i ALPHA BANK A.E-Tirana Branch ka vendosur të bëhet shtimi i Kapitalit Aksioner, në shumën 5,245,752.23 EUR (pesë milion e dyqind e dyzet e pesë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy pikë njëzet e tre euro), që ka të bëjë me fitimet pas tatimeve dhe pas krijimit të rezervave të detyrueshme.

Ky vendim është marrë në përputhje me pikën 8 të Rregullores së Bankës së Shqipërisë, Nr. 51, datë 22.04.1999 "Për Madhësinë dhe plotësimin e Kapitalit Fillestar Minimal, për veprimtaritë e lejuara për Bankat dhe Degët e Bankave të huaja të licencuara",

Gjithashtu Vendimi është marrë në përputhje edhe me Bilancin Kontabël të aprovuar nga Eksperti Kontabël i autorizuar i Bankës "KPMG-Albania" SHPK (ekspert i caktuar nga Alpha Bank A.E-Tirana Branch dhe miratuar nga Banka e Shqipërisë në përputhje me Rregulloren e Bankës së Shqipërisë, Nr. 06, datë 29.01.2003, "Për Ekspertët Kontabël të autorizuar të Bankave").

Shoqëria ka kërkuar depozitimin e dokumentacioneve të nevojshme në Regjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

PËR KËTO ARSYE:

 Pasi shqyrtova kërkesën dhe çmova se ajo është e drejtë dhe bazuar në Ligjin Nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" dhe në Ligjin nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare",

VENDOSA:

1. Pranimin e kërkesës
2. Depozitimin e Vendimit të Këshillit Drejtues të: "**ALPHA BANK A.E.-Tirana Branch**" të datës 27 Korrik 2006 për shtimin e Kapitalit Themeltar të "**ALPHA BANK A.E.-Tirana Branch**".
3. Pasqyrimin e ndryshimeve në skedën përkatëse të Regjistrit Tregtar.
4. Ky vendim tu komunikohet palëve të interesuara.

Urdhërohet Zyra e Regjistrit Tregtar të bëjë pasqyrimin e ndryshimeve në skedën përkatëse të "**ALPHA BANK A.E.- Tirana Branch**".

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

GJYQTARE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

Nr. _____ Vendimi

12825 / 12

VENDIM
I GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë 25/04 2007, unë P. Ponejohi gjyqtare pranë kësaj gjykate, pasi studiova kërkesën dhe dokumentet e paraqitura nga "ALPHA BANK A.E. - Tirana Branch", për depozitim aktësh të personit juridik,

KONSTATOVA SE:

"ALPHA BANK A.E.-Tirana Branch", është regjistruar në Regjistrin Tregtar me Vendimin Nr. 12825, datë 16 Nëntor 1995, te Gjykatës se Rrethit Tiranë dhe me Licensë Nr. 10, datë 07.01.1998, lëshuar nga Banka e Shqipërisë për të vepruar si Bankë në territorin e Republikës së Shqipërisë, me seli në Bul. "Zog I", Nr. 47, Tiranë, Shqipëri.

Më datë 19 Dhjetor 2006, Këshilli Drejtues i ALPHA BANK-Tirana Branch ka vendosur të bëhet ndryshimi i emrit të degës së Bankës nga "ALPHA BANK A.E.-Tirana Branch" në "ALPHA BANK- ALBANIA".

Ky vendim është miratuar edhe nga Banka e Shqipërisë në përputhje Ligjin Nr. 8365, datë 02.07.1998, "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë".

Shoqëria ka kërkuar depozitimin në Regjistrin Tregtar të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE:

Pasi shqyrtova kërkesën dhe çmova se ajo është e drejtë dhe bazuar në Ligjin Nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" dhe në Ligjin nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare",

VENDOSA:

1. Pranimin e kërkesës
2. Depozitimin e Vendimit të Këshillit Drejtues të "ALPHA BANK A.E.-Tirana Branch" të datës 19 Dhjetor 2006 për ndryshimin e emrit nga "ALPHA BANK A.E.- Tirana Branch" në "ALPHA BANK-ALBANIA".


3. Pasqyrimin e ndryshimeve në skedën përkatëse të Regjistrit Tregtar.

4. Ky vendim tu komunikohet palëve të interesuara.

 Urdhërohet Zyra e Regjistrit Tregtar të bëjë pasqyrimin e ndryshimeve në skedën përkatëse të shoqërisë "**ALPHA BANK A.E.- Tirana Branch**".

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

GJYQTARE

Peqeta Pona


FINANSA
U. Kuj.
Fark.

Alpina Credit Bank
25. 1. 1996
George Diamantopoulos

12825

Depozitim

① URTHER DEPOZITIMZ : dt _____ gj _____

② Kerkere : KERKUESZ : George Diamantopoulos dt 25. 1. 1996
NR Rep 93 NR Kol. 36

- a) Konferenca e depozitimit te kapituleve.
- b)
- c)

~~③~~ Vendim Asambleje : dt _____ / Vertetim /
NR Rep _____ NR Kol. 28 11. 1995
ortakz vetem _____ 600.000 \$

ortakët : _____

③ Fontrote shize kuotari : dt _____
SHITESZ : _____ % _____
Bleresi : _____ % _____

④ Vendim i gjyqtarit te vetem : dt 25/1/1996
NR 12825/A
GJ. Flora Tepu

⑤ NR e depozitimit ne liber : 1787

Carane me : 25/1/1996

STATUTI

Me dekret te dates 10 Mars 1918 (Gazeta Zyrtare 62/I4-3-18) Banka I.F.Kostopullos & Shoqeria, qe funksiononte ne qytetin e Kallamara tes si dege e Ndermarjes Tregetare qe kishte themeluar me 1879 Joanis .F. Kostopullos, u transformua ne Shoqeri Anonime me emertimin Banka Kallamon SA. Me 1924 Banka u transferua me seli me Athine duke u riemertuar ne Banke Greke e Kreditit TREGETAR SA. dhe me 1947 Ne BANKE E KREDITIT TREGETAR SA. Me 1965 Statuti i saj kodifikohet (Gazeta Zyrtare 30-/I-2-65) Statuti me modifikimin e dates 9-12-72 (Gazeta Zyrtare 1920) ku u publikua dhe shenja dalluese e Bankes . Shoqeria merr emertimin BANKA EKREDITIT SA. te cilin emertim e ruan dhe mbas ndryshimit te emertimit te saj ne ALFA BANKE KREDITI SA, i cili u vendos ne Asamblene e Pergjitheshme te Aksionereve me date 29-3-1994. Mbas ndryshimeve te reja dhe kodifikimit te ri ne tekst unik, Statuti i saj formulohet siç vijon:

KAPITULLI A.

Formimi . Emertimi . Selia . Kohezgjatja . Qellimi .

Neni I

Formohet shoqeri anonime bankare me emertimin ALFA BANKE E KREDITIT. dhe ne gjuhe te huaj ALPHA CREDIT BANK AE. dhe me shenjen dalluese BANKA E KREDITIT.

Neni 2

Selia (Qendra) e SHOQERISE caktohet Athina . Shoqeria ka mundesi me vendim te Keshillit Administrativ te saj te krijojë Filiale, Zyra ose njesi te tjera Shkembimesh si ne Greqi po keshtu edhe jashte saj.

Neni 3

Afati i Shoqerise ,i cili ka filluar me 10 Mars 1918 caktohet deri me 10 Mars 2018(dy mije e tetembedhjete) dhe mund te shtyhet me vendim te Asamblese se Pergjitheshme.

Neni 4

Qellimi i Shoqerise eshte aktivizimi i puneve bankare dhe jashte saj, sipas dispozitave qe jane ne fuqi.

Ne menyre treguese permenden punet si vijojne :

- a) Pranimi i depozitimit te te hollave te çdo lloji si: Pamjeje, Arke, me afat ose pa kufizim kohe, me interes ose pa interes ne llogari te perbashket ose me kushte.
- b) Dhenie kredie e huaje te çdo lloj forme, c) Parashlyerje ose paradhnie mbi valutoret dhe kambfalet me urdher ngarkesash , pjesese me interes, fatura te pjesëve, shkresa te pjesëve te pengjëve, dhe çdo lloj tjetër titulli tregëtar ose titulli tjetër , duke bere pazarimin dhe riparashlyerjen e tyre.
- ç) Dhenie kredie te garantuara.
- d) Dhenie garancish ne favor te te treteve dh) Shitblerje valute te huaj , gureve te çmuar e metaleve te rralle dhe monedhave .
- e) Dhenien dhe pagesen e çeqeve bankare e private , ne dhrahmi ose ne monedhe te huaj.
- f) Pagese mandatesh brenda dhe jashte shtetit.
- g) Dhenie kartash krediti dhe karta huaje.
- gj) Dhenie sherbimi rrogetimi financiar(LEASING) dhe parashlyerje pretendimesh (FACTORING -FORFAITING).
- h) Rruajtje shkresash financiare ose sendeve te tjera te çdo lloji dhe qiradhenie sportelese e kasafortash.

1) Dhenie çdo lloj huaje ose konventave te tjera krediti, dhe dhenie huash obligative per thithjen e kapitaleve.

2) Mbulimi obligacionesh dhe aksionesh per llogari te te treteve (UNDERWITING) ose per llogari te Bankes .

3) Pranim ne favor te qellimeve te dobishme, depozitimesh, te çdo lloji .

4) Dhenie huash tek persona Juridike , te se drejtes publike e asaj private, pjesemarrje ne to dhe marrje persiper te sherbimit te tyre, si dhe pjesemarrje ne dhenie huash te Shtetit.

II- Administrim pasurish te patundeshme depozitash dhe ne natyre, administrim te pasurise se te treteve.

I- Shitblerje letrash me vlere dhe vlerave te tjera, per llogari te te treteve , te çdo lloji letrave me vlere dhe vlerave faktike

2- Themelimin ose pjesemarrjen ne ndermarrjen te cilesdo forme, bankare ose jo , ne Greqi dhe jashte saj.

3- Perfaqesim te ndermarrjeve te tjera te cilat te cilat kane qellime te njejta.

KAPITULLI II

Neni 5

KAPITALI AKSIONAR. AKSIONET . AKSIONERET.

A- Kapitali aksionar i Bankes kap shifren tridhjetë e nente miliardë e gjashtëqind milion drahmi (39,600.000.000.) dhe pjesetohet ne nentëmbëdhjetë milion e tetëqind mijë (19.800.000.) aksione me vlere emerore dy mijë (2.000) drahmi secili. Kjo shume erdhi si rezultat :

I- Nga kapitali fillestar (1.000.000) Drahmi , nje milion ku mbas shtesash te here mbas hereshme , arriti mbas shteses se 22 Korri-

rikut te vitit 1982 ne dy miliarde e gjashteqind e dyzet milione (2.640.000.000) drahami, dhe pjesetohet ne nje milion e shtateqind nje (1.760.000) aksione me vlere emerore nje mije e peseqind (1.500) drahami secili



Nga shtesa e cila u realizua me vendim te Asamblese se Jashteza-
koneshme te Pergjitheshme te dates 5 Maj 1987 me shumen (660.000.
000) gjashteqind e gjashtedhjete milion drahami, pjesetuar ne kate-
rqind e dyzet mije (440.000) aksione me vlere emerore nje mije e
peseqind (1.500) drahami secili dhe disponibile tre mije e gjashte-
qind (3.600) drahami .

Nga shtesa e cila u realizua me vendim te Asamblese se Zakoneshme
te Pergjitheshme te dates 7 Qershor 1988 ne shumen , nente miliard
e nenteqind milion (9.900.000.000) drahami e cila erdhi si rezultat :

- a) Nga kapitalizimi i mbivleres se te patundeshmeve, 5.347.916.000
- b) Nga kapitalizimi i mbivleres se depozites se dispozicionit te aksioneve mbi te ploten, 1.147.068.000 .
- c) NGA kapitalizimi i rezerves depozituese te shitjes se shkresave borxh 105.016.000 dhe d) Te numuruara 3.300.000.000 drahami.

Per kete shtese qe kap shumen e 9.900.000.000 u dhane:

- a) 2.200.000 aksione te rinj me vlere emerore 3.000 drahami secili te cilat baraspeshojne me kapitalizimin e mbivleres se te patundeshmeve dhe te rezervave depozituese dhe
- b) 1.000.000 aksione te rinj me vlere emerore 3.000 drahami secili te cilat kane vlere disponibile 4.800 drahami secili qe baraspeshojne ne rritjen me pagese ne te holla te numuruara. Po me te njejtin vendim te Asamblese se Pergjitheshme te dates 7-6-88 zvogelimi i aksioneve ekzistuese 2.200.000 aksione ne 1.100.000 dhe

njekohesisht rritja e vleres se tyre emeruese nga I.500 dhrahmi ne 3.000 dhrahmi secili aksion.



Me vendim te Asamblese se Zakoneshme te Pergjitheshme te dates 9 Qershor 1990 ,u vendos dyfishimi i aksioneve ekzistuese nga 4.400.000 ne 8.800.000 kaq sa pakesimi i vleres se tyre emerore nga 3.000 ne I.500 dhrahmi secili.

ç)Nga shtesa e cila u realizua me vendim te Asamblese se Pergjitheshme te Jashtezakoneshme te dates 4 Shtator 1990 ne shumen nje miliard e gjashteqind e pesedhjete milione (I.650.000.000)dhrahmi i pjesetuar ne nje milion e njeqind mije (I.I00.000) aksione me vlere emeruese nje mije e peseqind (I.500) dhrahmi secili dhe me vlere disponibile I5.000 secili.

d)Nga rritja qe u realizua me vendim te Asamblese se Zakoneshme te dates 29 Mars 1994 ne shumen 24.750.000.000 njezet e kater miliard e shtateqind e pesedhjete milion dhrahmi e cila erdhi nga:

I- Rritja e vleres emeruese te nente milion e njeqind mije (9.900.000) aksioneve nga I.500 dhrahmi ne 2.000 dhrahmi secili, nga kapitalizimi i nje pjese te rezerves nga aksionet e vena ne dispozicion mbi te ploten ne (4.950.000.000) kater miliard e nenteqind e pesedhjete milion .

2-Venien ne dispozicion falas te (6.600. 000) gjashte milion e gjashteqind mije aksione me vlere emeruese 2.000 dhrahmi secili , nga kapitalizimi i mbivleres se te patundeshmeve sipas Ligjit , ne 752.094.095 nga kapitalizimi i pjeses se mbetur nga vevia ne dispozicion mbi shumen e plote ne dhrahmi II.880.000 000. ngak kapitalizimi i pjeses se mbetur te fitimit ne fitim te ri ne (567.905,905) dhrahmi.

3. Venia ne dispozicion te 3.300.000 aksioneve me vlere emeruese
2.000 secili ne vlere disponibile nente mije e peseqind secili
(9.500) dhrahmi.

Bartja e kapitalit aksionar behet me vendim te Asamblese se
Pergjitheshme ose te Keshillit Administrativ sipas Nenit I3 te
KN.2I90/I920 ose sipas dispozitave ne fuqi. Ne te dy keto ra-
ste vendimi percakton menyren e dhenies se aksioneved dhe vleren
e dheniesse tyre. Bankes i ndalohet fitimi i aksioneve te
saj si ng ajo vete, ashtu dhe nga personi qe vepron ne emer te
vet por per llogari te Bankes.

Nga ndalimi i mesiperu perjashtohen:

- a. Fitimet meq qellim , pakesimin e kapitalit aksionar qe u vendos nga Asamblea e Pergjitheshme,
 - b. Fitimet mbas mbartjes teresisht te pasurise.
 - c. Fitimet e aksioneve qe jane paguar plotesisht ,ose vijne nga ekzekutimi i detyruar i cili ube per pagesen e kerkesave te Bankes.
 - d. Fitimin e aksioneve te saj por me urdher te te treteve.
 - e. Fitime nga shkaqe dhuruese , kur jane paguar plotesisht ose
 - f. Fitime qe kane per qellim shperndarjen e aksioneve tek Personeli i Bankes ose tek Personeli i Shoqerise qe ashte lidhur Shperndarja e ketyre aksioneve duhet te realizohet brenda afatit I2- Mujor nga dita e fitimit te tyre dhe mbas kalimit te ketij afati hyn ne fuqi dispozita e paragrafit 3 i nenit I6 te K.N. 2I90/I920 persa u perket rasteve c.dhe d.
- Fitimi i aksioneve ne kete rast behet me kushtet e meposhtme :
Kur vlere emeruese e ketyre aksioneve se bashku me vleren

emeruese te aksioneve spontane, te rasteve , a dhe d. nuk mbi
 Alon I/IO-ten te kapitalit aksionar.

Kur nuk sjell uljen e shumes vete kapitaleve te Bankes, siç per-
 caktohen ne pasqyren e bilancit qe parashikohet nga Neni 42 i
 K.N. qe eshte ne fuqi , mbas zbatimit te K.D. 409/81 nen shumen
 qe parashikon paragrafi I i Nenit 44 a, i te njejtit Ligj.

Neni 6

Aksionet jane emeruese , te pajsetueshme dhe jepen ne tituj
 te nje ose me shume aksioneve. Neqoftese ekzistojne shume pro-
 nare ne nje aksion , jane te detyruar te gjithë bashkepronaret
 te njoftojne me shkrim tek Shoqeria , perfaqesues te perbashket
 per kete aksion. Derisa te caktohet perfaqesuesi anulohet
 e drejta ushtruese mbi aksionin.

Neni 7

Pergjegjesia e aksionarit kufizohet tek kapitali emerues te
 aksioneve te tij, çdo aksion jep te drejten e nje vote
 ne Asamblene e pergjitheshme.

Neni 8

Cilesia e aksionarit dhe zoterimi i titullit te aksionit du-
 het te pajtohet me pranimin e ketij Statuti, dhe ndryshimeve
 te tij eventuale dhe ne baze te Ligjit e vendimeve te Keshillit
 Administrativ dhe Asamblese se Pergjitheshme te Shoqerise,

Neni 9,

Per çdo mosmareveshje ndermjet Shoqerise dhe aksionereve
 te drejten ekskluziv te zgjidhjes se tyre e ka Gjykata e A-
 shines , ku vetem para asaj mund te paditet Shoqeria ,akoma
 dhe ne rastet e cilesdo mareveshjeje te veçante.

KAPITULLI III

Asambleja e Pergjitheshme e aksionereve.

Neni 10

Asambleja e Pergjitheshme e aksionereve perben organin me
 te larte te Shoqerise, perfaqeson shumicen e aksionereve
 dhe vendos per te gjitha çeshtjet e Shoqerise. Te gjitha
 vendimet qe merr Asambleja e Pergjitheshme sipas ligjit
 angazhojne te gjithe aksioneret.

Neni 11

Asambleja e Pergjitheshme thirret nga Keshilli Administrativ
 dhe mblidhet ne seline e Shoqerise rregullisht gjate gja-
 shtemujorit te pare , mbas mbarimit te mandatit shoqeror ,
 por mblidhet dhe ne menyre te jashtezakoneshme, kur e gjy-
 kon te nevojeshme Keshilli Administrativ.

Neni 12

Asambleja e Pergjitheshme , me perjashtim te mbledhjeve te pe-
 rseritura ose dhe ato qe ngjajne me ato, thirret te pakten
 njezet dite kalendarike para mbledhjes se saj. Date e mbledhjes
 dhe data e njoftimit nuk permblihen ne kete afat.

Ftesa e thirrjes se Asamblese se Pergjitheshme cakton vendin
 sallen, daten, vitin dhe oren e mbledhjes si edhe çeshtjet e
 rendit te dites, me qartesi, afishohet ne vend evident ne mur
 tek Zyrrat Qendrore te Bankes dhe publikohet sipas Ligjit 10
 dite para ne Gazeten Zyrtare te Qeverise ne (Vellimin e S.A
 dhe shoqerive me pergjegjesi te kufizuar) sidhe 20 dite para
 ne nje nga gazetate me tirazh te madh qarkullimi ne Athine, gji
 thmone sipas gjykimit te Keshillit Administrativ edhe ne ga
 zetat e tjera politike qe qarkullojne ne te gjithete vendin sidhe
 ne gazetate e perditeshme ekonomike te caktuara nga Ministria
 e Tregetise.

Asambleja e prgjitheshme nuk ka te drejte te shqyrtoje çeshtje
 te cilate nuk jane percaktuar ne rendin e dites.

Kur behet fjale per mbledhje te perseritura te Asamblese
 se Pergjitheshme afatet e mesiperme shkurtohen ne gjysem.

Neni 13

Qe te marre pjese ne Asamblene e Pergjitheshme aksioneri du
 het te depozitoje aksionet e tij ne Banke ose ne çdo Banke
 tjeter ne Greqi ose jashte saj, ose ne Arken e Depozitimeve
 dhe Huave, pese dite me pare se mbledhja. Ata qe marrin pjes
 ne Asamblene e Pergjitheshme, kane te drejten te perfaqesohen
 nga nje person qe e autorizojne, duke dorezuar per te nje
 shkrese ne Banke ne afatet qe permenden tek Neni i meparshem.
 Personat juridike, personat nen moshe, te ndaluarit dhe te tjere
 qe sipas Ligjit nuk mund te marrin pjese, perfaqesohen vetem

nga perfaqesuesit e tyre te ligjshem. Dyzetete ore para çdo mbledhje te Asamblese se Pergjitheshme ekspozohet ne nje vend te dukshem ne Zyrat Qendrore te Bankes, table e aksionereve te cilet kane te drejte vote ne kete Asamble te Pergjitheshme, perfaqesuesit e tyre, numrin e aksioneve dhe votave te tyre sidhe adresat e aksionereve dhe perfaqesuesve te tyre. Verrejtjet kunder kesaj table, mund te parashtrohen me pare se te filloje hapja e rendit te dites.

Neni I4

Aksioneri, ka te drejten, dhjete dite para mbledhjes se Zakonshme te Asamblese se Pergjitheshme, te kerkoje bilancin e raportet e Keshillit Administrativ dhe te Revizoreve.

Neni I5

- I. Asambleja e Pergjitheshme mund te filloje mbledhjen per çeshtje te rendit te dites, kur paraqiten ose perfaqesohen ne te, aksionere qe perfaqesojne te pakten 1/5 -en e kapitalit te Shoqerise.
2. Neqoftese nuk arrihet kjo pjesemarje, Asambleja e Pergjitheshme mund te mblidhet serismi brenda njezet diteve nga data e anulimit te mbledjes se pare, duke lajmeruar te pakten dhjete dite me pare, duke filluar mbledhjen pa mare parasysh sa jane aksioneret, dhe sa aksione te kapitalit perfaqesojne, shqyrton çeshtjet e rendit te dites.

Μεταφραστική Υπηρεσία Υπουργείου Εξωτερικών, Αθήνα
Service des Traductions du Ministère des Affaires Étrangères de la République Hellénique, Athènes
Hellenic Republic, Ministry of Foreign Affairs, Translations Service, Athens



REPUBLIQUE HELLENIQUE
MINISTRE DES AFFAIRES ETRANGERES
Vu pour legalisation de la signature ci-dessus
du Traducteur du Ministère des Affaires
Etrangères ayant traduit le texte ci-annexé.


Athènes le, - 5 OCT 2007



PAR DÉLÉGATION DU MINISTRE
Le Directeur p.m.

DOUGENI - PANAGIOTAKOU AFRODITI
Secrétaire

PULLE TAKSE



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr 8029 Rep.

STUDIO NOTERIE
MALLKUCI & SADUSHAJ

VERTETIM

Sot me date 01.11.2007, para meje A. Ollukuci, notere ne qytetin
Tirane me zyre ne Rr. "Vaso Pasha", Pall. 13/1, u paraqit personalisht,

Endrit Demiri, lindur me 03/06/1973 banues ne Tirane, me zotesi te plote
per te vepruar, me dokument identifikimi shq.ohur, i cili me paraqiti origjinalin

e Akt vertetim dokumenti privat me nr 39.514
e datës 24/09/2007 e "Alpha Bomb"

qne une noterja vertetoi se fotokopja eshte e rrejte me origjinalin.

NOTERE

NOTERE
ARJAN R. MALLKUÇI
Tel: Zyre 250253,266242

1237
22/08/06



Ilirita,
Ades
Per te fjaluar me
Ernst & Young
OK

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPERISE**



Sheshi "Skënderbej", No. 1, Tirana - Albania • Tel: ++355 4 222230; 222750; 235568
• Fax: ++355 4 223558 • Website www.bankofalbania.org • E-mail: public@bankofalbania.org

DEPARTAMENTI I MBIKEQYRJES
SEKTORI I LICENCIMIT, RREGULLIMIT DHE STANDARDEVE
Nr. 3402 Prot.

Tirane, me 21.8.2006

Për: **BANKËN ALFA - DEGA TIRANË**

TIRANE

Lënda: Miratimi i ekspertit kontabël të autorizuar për vitin 2006 - Ernst&Young Albania sh.a.


I nderuar zoti Drejtor

BANKA E SHQIPËRISË, mori në shqyrtim kërkesën dhe dokumentacionin përkatës, paraqitur nga ana juaj me shkresën nr. 1682 prot., datë 26.06.2006 "Për miratimin e ekspertit kontabël të autorizuar" për kontrollin e raporteve financiare të vitit 2006 - shoqërinë Ernst&Young Albania sh.a. Mbështetur në kërkesat e rregullores "Për ekspertët kontabël të autorizuar të bankave", miratuar me vendimin Nr. 06, datë 29.01.2003 dhe ndryshuar me vendimin nr.102, datë 10.12.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, Banka e Shqipërisë

Jep miratimin për emërimin e shoqërisë audituese Ernst&Young Albania sh.a., për të bërë auditimin e Bankës Alfa - Dega Tiranë për vitin 2006.

Me respekt

Klodion SHEHU
DREJTOR



PULLE TAKSE



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 8576 Rep.

STUDIO NOTERIE
MALLKUCI & SADUSHAJ

VERTETIM

NOTERE


Sot me date 20.11.2007, para meje ARIANA R. MALLKUCI notere ne qytetin Tirane, me zyre ne Rr. " Vaso Pasha ", Pall. 13/1, u paraqit personalisht.

Endrit Demiri, lindur me 3.6.1973 dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me dokument identifikimi i njohur, i cili me paraqiti origjinalin e

Olikatim i Kartes se Identitetit Mentabel te autorizuar
dt. 21.8.2006 me Nr 3402/1 Prut.

dhe une noterja vertetoj se fotokopja eshte e njejte me origjinalin.

NOTERE



NOTERE
ARIANA R. MALLKUCI
12310250253.266242




Taxes and Provision for the year 2006

in eur

Profit according to our books	1,130,646,972.90	9,129,164.09
Housing expenses	504,000	
Travel expenses	1,231,328	
Expenses per diem	882,796	
Nutritional & other domestic expenses	1,463,234	
Other domestic expenses	5,500,808	
Penalties	82,606	
Fixed assets depreciation (not accepted amounts)	1,214,260	
total	10,879,032	
Taxable profit	1,141,526,005.39	9,217,004.48
Applicable tax rate	0.20	
Tax to be paid	228,305,201	
Taxes prepaid	311,600,000	
Diference on tax profit	83,294,799	
Profit after taxes	902,341,772	7,285,763.20
Provision on assets (1/5 of net profit)	180,468,354	1,457,152.64
Net amount to be transferred te Head Office	721,873,417	5,828,610.56


O.DNUCI


I.PRIFTI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 8200 Rep.

STUDIO NOTERIE
MALLKUCI & SADUSHAJ

VERTETIM

Sot me date 05.11.2007, para meje A. Mallkuqi, notere ne qytetin
Tirane me zyre ne Rr. " Vaso Pasha ", Pall. 13/1, u paraqit personalisht,

Alban Bellio, lindur me 04.08.1980 banues ne Tirane, me zotesi te plate
per te vepruar, me dokument identifikimi Z-1266463, i cili me paraqiti origjinalin

e Pasaportës nr. Z-1266463


che une noterja vertetoi se fotokopja eshte e njejte me origjinalin.

NOTERE

NOTERE

RIANA R. MALLKUCI

Zyre 250253.266242





ALPHA BANK

Tirana Branch



Tiranë më 28.03.2007

AUTORIZIM

Me anë të së cilit **ALPHA BANK A.E. – Tirana Branch**, person juridik, regjistruar me Vendimin Nr. 12825, datë 16 Nëntor 1995, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me seli në Bul. "Zog I", Nr. 47, Tiranë, Shqipëri, autorizon:

Avokat **Alban Bello** me License Nr.2625, që të përfaqësojnë subjektin tonë "**ALPHA BANK A.E - Tirana Branch**" pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me këtë cilësi përfaqësuesi ka të drejtë, të paraqitet pranë Gjykatës në emër dhe për llogari të Bankës, të paraqesi cdo kërkesë për depozitim aktesh të subjetit tonë drejtuar Gjykatës, si dhe të tërheqi cdo Vendim në lidhje me depozitimet e akteve.

Pwr "ALPHA BANK A.E - TIRANA BRANCH"

Andreas Galatoulas

ALPHA BANK A.E.
TIRANA BRANCH (N.K.020)

Orfea Dhuci



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË

Sheshi "Skënderbej", No. 1, Tirana - Albania • Tel: ++355 4 222230; 222750; 235568
• Fax: ++355 4 223558 • Website www.bankofalbania.org • E-mail: public@bankofalbania.org

DEPARTAMENTI I MBIKËQYRJES

Sektori i Licensimit, Rregullimit dhe Standarteve

Nr. 371/11 Prot.

Tiranë, më 16.02.2007

Për: Bankën Alpha A.E.-Dega Tirane
Tiranë

Në vëmendje të: Z. Andreas GALATOULAS
Drejtor i Degës

Lënda: Mbi ndryshimin e emrit të Bankës Alpha A.E.- Dega Tirane

I nderuar Z. Galatoulas,

Referuar shkresës Tuaj Nr.0063 datë 19 janar 2007, për ndryshimin e emrit te Bankes Alpha-Dega Tirane, Banka e Shqipërisë mbështetur në rregulloren Nr.71, date 11.09.2002 "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë", vëren sa vijon;

Shoqëria " Alpha Credit Bank A.E." me seli në Athinë mbështetur në vendimin e Bordit të saj Drejtues me 21 shtator 1995 kishte vendosur hapjen e degës së saj në Tiranë. Mbështetur në kërkesat ligjore dhe rregullative në fuqi për atë kohë Banka e Shqipërisë vendosi t'i japë Degës në Tiranë të Bankës Alpha Credit licencën për të ushtruar veprimtari bankare. Në shqyrtimin e të gjitha kërkesave për marrjen e këtij vendimi Banka e Shqipërisë është mbështetur në situatën financiare, statutin, mënyrën e organizimit dhe organet drejtuese dhe kontrolluese të bankës Meme- sot me emër të ndryshuar Alpha Bank A.E. Edhe emri aktual i degës shpreh këtë status .

Mbështetur ne kërkesën tuaj dhe në nismën e ndërrmarrë kohët e fundit nga Grupi i Alpha Bank A.E në Greqi për ndryshimin e emrit në rrjetin e degëve në vëndet e tjera, Banka e Shqipërisë shprehet dakort për ndryshimin e emrit nga Banka Alfa-Dega Tiranë në Alpha Bank-Albania, pa ndryshuar statusin e degës.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Fatos Ibrahim
ZEVËNDËSGUVERNATOR I PARË

NUMUR 38.410

AKT DEPOZITIMI DHE VERTETIMI DOKUMENTI

Në Athinë sot me dymbëdhjetë (12) shkurt të vitit dymijë e shtatë (2007),ditën e henë,në pallatin e rrugës Stadhiu numur 40,ku gjenden zyrat e Administratës së «ALPHA BANK SH.A.»,e pronësisë time,ku më ftuan dhe erdha për nënshkrimin e kësaj prokure,teke unë notere dhe banore e Athinës IRINI EMMANUIL VASILIKAKI,me seli në Athinë (Stadhiu 43-katin i 7-të),u paraqit i papërrjashtuari prej ligjit z.SPIROS FILARETOS i NIKOLAUT dhe ANASTASIAS-AHEPA,që u lind në Athinë në vitin 1958,Këshilltar i Autorizuar dhe Drejtor i Përgjithshem i Shoqërisë Anonime Bankare me emërtimin «ALPHA BANK SH.A.»,banor i Athinës (rruga Stadhiu nr.40),mbajtës i letërnjoftimit të Seksionit të 3-të të Asfalisë së Athinës me numur I-089.513/4-10-1972,i cili vepron në rastin konkret si përfaqësues i ligjshem i shoqërisë anonime bankare me seli në Athinë (rruga Stadhiu nr 40-105 52)me emërtimin «ALPHA BANK SHOQERI ANONIME» dhe me titullin tregues «ALPHA BANK»,person juridik i së drejtës private,e cila u krijua sipas kontratës statutore me numur 43.651/1918 të noterit të Athinës Irakleus Karkulia,që u botua ligjerisht në numrin 62 të datës 14.3.1918 të Gazetës Zyrtare,kopje të të cilit i bashkangjitet prokurës sime me numur 33.409/2004.

Statuti i Bankës së mësipërme,sipas vendimit të datës 6-6-2006 të Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionereve u **modifikua dhe u kodifikua** dhe u rregjistrua në rregjistrin e shoqërive anonime të Ministrisë së Zhvillimit me 12-10-2006 me numur protokolli K2-14362,siç rezulton prej njoftimit të datës 12-10-2006 të Ministrisë së Zhvillimit,fotokopje e legalizuar e të cilit i bashkangjitet aktit tim me numur 37791.2006.

Këshilli i fundit Drejtues i Bankës u zgjodh për një pesëvjeçar gjatë Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionerëve të datës 19-4-2005,u mlodh në korpus gjatë seancës së datës 19-4-2005.Ekstrakt procesverbali të Këshillit Drejtues i bashkangjitet prokurës time me numur 35179/2005,u rregjistrua në Rregjistrin e Shoqërive Anonime të Ministrisë së Zhvillimit me 12-5-2005 me numur protokolli K2-5911/2005 dhe u botua ligjerisht në numrin 2930/13-5-2005 të



Gazetës Zyrtare, fashikulli i SH.A. dhe SH.P.K., kopje e të cilit i bashkangjitet prokurës time me numur 35179/2005.

Këshilli i mësipërm drejtues u rimblodh përseri si organ me 27-7-2006 pas zgjedhjes së antari të ti të K.D. në zëvendësim të antarit që dha dorëheqje. Ekstrakt procesverbali të Këshillit Drejtues i bashkangjitet prokurës sime me numur 37626/2006, u rregjistrua në Rregjistrin e Shoqërive Anonime të Ministrisë së Zhvillimit me 28-8-2006 me numur protokolli K2-11698/2006 dhe u botua ligjerisht në numrin 9257/29-8-2006 të Gazetës Zyrtare, fashikulli i SH.A. dhe SH.P.K.

Banka e mësipërme ka Numur Identifikimi Personi të Tatueshem 094014249 të D.O.Y. FAEE Athinës dhe N.A.SH.A.6066/06/B/86/05.-

I paraqituri, me cilesinë me të cilet është prezent, kërkoi të depozitojë dhe depozitoi dokumentin e mëposhtem: «EKSTRAKT PROCESVERBALI të Mbledhjes së datës 19.12.2006», që nënshkruhet prej Sekretarit të Këshillit Drejtues të shoqërisë së mësipërme bankare.-

I paraqituri i mësipërm kërkoi sipas ligjit vërtëtimin e dokumentit të mësipërm (procesverbalit) për marrjen e kronologjisë së sigurtë si dhe vërtëtimin e nënshkrimit të vet në aktin prezent për marrjen e kronologjisë së sigurtë.-

Unë noterja a) vërtetova dokumentin e mësipërm, siç kërkohet prej nenit 446 të Kodit të Procedurës Civile, domëthënë e nënshkrova dhe e vërtetova me vulën time zyrtare dhe b) vërtetova origjinalitetin e nënshkrimit të të paraqiturit në kopjen e legalizuar të aktit tim prezent dhe ja dorëzova të paraqiturit..-

Në garanci të të gjithave sa më sipër u redaktua ky akt në dy (2) fletë, për të cilin u paguan si taksë dhe tagër e ime me një (1) kopje tridhjetë e dy euro dhe 0,40 sent (32.40) dhe pasi iu lëxua me zë të lartë dhe qartazi të paraqiturit, i cili u sigurua dhe ra dakort me përmbajtjen e tij, nënshkruhet prej tij dhe prej meje noterës konform ligjit.

I PARAQITURI
SPIROS FILARETOS

NOTERJA
(T.S.) IRINI EMM. VASILIKAKI

Kopje identike, brenda ditës
nënshkrimi-vula

VERTETOHET

Sipas nenit 446 të Kodit të Procedurës Civile me aktin tim me numur 38411/07.



ALPHA BANK

KESHILLI DREJTUES

EKSTRAKT PROCESVERBALI

I Mbledhjes së datës 19.12.2006

Të martën me 19 dhjetor 2006 dhe në orën 11.00 Këshilli Drejtues u mbledh në selinë e Bankës, Stadhiu 40, dhe në sallën e Këshillit Drejtues në katin e 7-të.

Ftesa respektive iu dërgua të gjithëve me 13.12.2006.

Ishin prezent:

Kryetari z.Jannis S.Kostopoulos, Zv/Kryetari z.M.J.Tanes, Këshilltari Drejtues z.D.P.Manxunis, Këshilltarët e Autorizuar dhe Drejtorët e Përgjithshëm z.z.M.S.Jannopoulos, S.N.Filaretos dhe A.H.Theodoridhis, anëtarët z.z.J.E.Aguridhis, P.A.Athanasopoulos, S.J.Eleftherudhaki, S.P.J.Karakostas, I.K.Liras, N.I.Manesis dhe Sekretari i Këshillit z.E.P.Verikios.

Nuk ishin prezent sepse nuk kishin mundësi z.z.P.A.Apostolidhis dhe A.M.Veremis.

Kryetari verën se Këshilli Drejtues ka kuorum.

23. Ndryshimi i emërimit të rrjetit të Bankës në Shqipëri


Kryetari informon Këshillin Drejtues të Bankës se tash rrjeti i Bankës tonë në Shqipëri numëron 15 Agjenci me plan të arrij në 18 deri në fund të vitit të ardhshëm. Këto agjenci bankare gjenden në Tiranë dhe në pjesën tjetër të territorit të shtetit shqiptar. Meqenëse emërtimi i Bankës, siç paraqitet sot (ALPHA BANK-Tirana Branch) nuk i përgjigjet realitetit dhe perspektives së zhvillimit të Bankës në këtë vend, është e nevojshme të ndyshojë emërtimi nga ALPHA BANK SH.A.-Tirana Branch, në ALPHA BANK-ALBANIA.

Këshilli Drejtues pas diskutimeve miratoi ndryshimin e propozuar në emërtimin.

Ekstrakt identik prej Librit të Procesverbaleve të Këshillit Drejtues.

Sekretari i Këshillit Drejtues

E.P.VERIKIOS



Sipas nenit 446 të Kodit të Procedurës Civile
me aktin tim me numur 38410/07

Athinë, me 12.02.07

NOTERJA

nëshkrimi-vula

N/R95/2007

Vërtëtohet origjinaliteti i nënshkrimit të Noterës së Athinës Irin Vasilikaki, sipas ekzemplareve të nënshkrimeve që ruhen në arkivin e Prokurorisë (neni 25 paragr.3b-24 paragr.5b të Ligjit 1756/88). Athinë, me 1.3.2007

Prokurori

Panajotis S. Panajotopoulos

Prokuror Pranë Gjykatë së Shkallës së Parë

nëshkrimi-vula


Shefja e Seksionit e Ministrisë së Drejtësisë znj. Hariklia Karpuzu vërtëton origjinalitetin e nënshkrimit të Prokurorit P. Panajotopoulos.

Sekretarja e Ministrisë së Jashtme të Republikës Greke znj. Evgenia Vasilopulu vërtëton origjinalitetin e nënshkrimit të H. Karpuzu në Ministrinë Greke të Drejtësisë.

Përkthyer në gjuhën shqipe sipas origjinalit bashkangjitur në gjuhën greke.

Athinë, me 05.03.2007

Përkthyesi: Kosta Naço


K. Naço



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 1427 Rep.

STUDIO NOTERIE
MALLKUCI & SADUSHAJ


VERTETIM

Sot me date 17.3 2007, para meje Arjana R. Mallkuci, notere ne qytetin Tirane, me zyre ne Rr. "Vaso Pasha", Pall. 13/1, u paraqit personalisht,

Alban Ilir Delle, lindur me 04.08.1980 me banim ne Tirane, me dokument identifikimi nr. injhun, i/e cili me paraqiti origjinalin e dokumentit "ndryshim ceteri bankes" nga Banka e Shqiperise dt 16.02.2007 Nr. 371/1 prot.
dhe une noterja vertetoj se fotokopja eshte e njejte me origjinalin.

NOTERE

Arjana R. MALLKUCI





ALPHA BANK



Tiranë më 05.11.2007

AUTORIZIM

Me anë të së cilit **ALPHA BANK-ALBANIA**, një degë Banke e organizuar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Regjistrin Tregtar me Vendimin Nr. 12825, datë 16/11/1995, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Shqipëri, me seli në Bulevardi "Zog I", Nr. 47, Tiranë, Shqipëri, autorizon :

Avokatët **Av. Alban Bello, Av. Endrit Demiri dhe Av. Dorian Kashuri**, që se bashku ose veç e veç, të përfaqësojnë subjektin tonë **ALPHA BANK-ALBANIA** pranë:

- Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (Q.K.R) për të aplikuar për bërjen e ndryshimeve të ndryshme në lidhje me subjektin tonë dhe për të tërhequr Certifikata, ekstrakte, vërtetime, dhe çdo lloj dokumentacioni tjetër në emër dhe për llogari të Bankës.

Me këtë cilësi përfaqësuesi(t) kanë të drejtë që, së bashku apo veç e veç, të nënshkruajnë dhe të paraqesin çdo kërkesë drejtuar këtij institucioni, të bëjnë ankim në organet administrative dhe gjyqësore, si dhe të kryejnë çdo veprim procedurial të nevojshëm e të ligjshëm deri në arritjen e qëllimit për të cilin është lëshuar ky autorizim.

"ALPHA BANK - ALBANIA"

~~ALPHA BANK - ALBANIA~~

A. Gaatouras

O. Dhuci

1237
22/08/06



1 ditë,
Aolis
Për të fuqizuar në
Ernst & Young
[Signature]

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPERISE**

Sheshi "Skënderbej", No. 1, Tirana - Albania • Tel: ++355 4 222230; 222750; 235568
• Fax: ++355 4 223558 • Website www.bankofalbania.org • E-mail: public@bankofalbania.org

**DEPARTAMENTI I MBIKEQYRJES
SEKTORI I LICENCIMIT, RREGULLIMIT DHE STANDARDEVE**

Nr. 3402 Prot.

Tirane, me 21.8. 2006

Për: **BANKËN ALFA - DEGA TIRANË**

TIRANE

Lënda: Miratimi i ekspertit kontabël të autorizuar për vitin 2006 - Ernst&Young Albania sh.a.

I nderuar zoti Drejtor

BANKA E SHQIPËRISË, mori në shqyrtim kërkesën dhe dokumentacionin përkatës, paraqitur nga ana juaj me shkresën nr. 1682 prot., datë 26.06.2006 "Për miratimin e ekspertit kontabël të autorizuar" për kontrollin e raporteve financiare të vitit 2006 - shoqërinë Ernst&Young Albania sh.a. Mbështetur në kërkesat e rregullores "Për ekspertët kontabël të autorizuar të bankave", miratuar me vendimin Nr. 06, datë 29.01.2003 dhe ndryshuar me vendimin nr.102, datë 10.12.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, Banka e Shqipërisë

Jep miratimin për emërimin e shoqërise audituese Ernst&Young Albania sh.a., për të bërë auditimin e Bankës Alfa - Dega Tiranë për vitin 2006.

Me respekt

Klodion SHEHU
DREJTOR

[Signature]
[Official Seal]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË

Nr. 3813 Rep.
Nr. — Kol.



VËRTETIM

Sot, më datë 20/03 2007, përpara meje notari, noter i Dhomës së Noterëve Tiranë, u paraqitën personalisht Z. **Andreas Galatoulas**, i biri i **Antonios**, shtetas Grek, lindur më 23 Shtator 1952, në Athinë - Greqi, mbajtës i pasaportës A 706061, banues në Tiranë, në prani të përkthyeses së gjuhës Greke Maria Vila dhe Z. **Orfea Dhuci**, i biri i Vangjelit, lindur më 09.11.1958 në Gjirokastrë, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës nr. 0253636, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e Përfaqësuesve Ligjor të "ALPHA BANK A.E. - Tirana Branch", të cilët më deklaruan se këtë kërkesë për depozitim aktesh e kanë përpiluar në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, dhe pasi ata nënshkruan në praninë time, unë noter i vërtetoj nënshkrimet e tyre sipas ligjit.

Perkthyesë
Maria Vila

NOTER





**VENDIM I DREJTORISË RAJONALE TË
"ALPHA BANK A.E.-TIRANA BRANCH"**

Sot me date 07 Korrik 2005 (Dymije e pesë), u mbajt mbledhja e Drejtorisë Rajonale të "ALPHA BANK A.E.-TIRANA BRANCH" një degë Banke e Organizuar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Regjistrin Tregtar me Vendimin Nr. 12825, datë 16/11/1995, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Shqipëri, me seli në Bulevardi ZOGU I, Nr. 47, Tiranë, Shqipëri, që mban liçensën Nr. 10, datë 07.01.1998, lëshuar në përputhje me Legjislacionin Shqipëtar për Bankat, degë e Alpha Bank A.E., një Bankë e Organizuar dhe që funksionon në bazë të Legjislacionit Grek (ALPHA BANK). Të pranishëm në mbledhje ishin:

1. **Andreas Galatoulas**, i biri i **Antonios**, shtetas Grek, mbajtës i pasaportës A 706061, banues në Tiranë, Bulevardi "Zog I", nr. 47/1; Drejtor i Përgjithshëm (në prani të përkthyeses së gjuhës greke Maria Vila) dhe
2. **Orfea Dhuci**, i biri i **Vangjelit**, shtetas Shqiptar, mbajtës i pasaportës nr. Z 1383851, banues në Tiranë të dy madhorë me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

Pasi mori ne shqyrtim pikat e rendit te dites si me poshte:

1. Emërimin e auditorit të jashtëm njëkohësisht ekspert kontabël i autorizuar të ALPHA BANK A.E.-Tirana Branch për kontrollin e raporteve financiare për vitin 2005.
2. Nënshkrimin e Kontratës përkatëse me shoqërinë e përzgjedhur

Drejtimesit Rajonale te "ALPHA BANK A.E.-TIRANA BRANCH" me unanimitet:

VENDOSËN SA ME POSHTE VIJON:

1. Emërimin e shoqërisë "KPMG-Albania" SHPK si auditor të jashtëm njëkohësisht ekspert kontabël i autorizuar të ALPHA BANK A.E.-Tirana Branch për kontrollin e raporteve financiare për vitin 2005.
2. Nënshkrimin e Kontratës përkatëse me shoqërinë "KPMG-Albania" SHPK

Duke qene se nuk kishte me beshje per te diskutuar, mbledhja u mbyll dhe Drejtimesit Rajonale nenshkruan vendimin e mesperm.

"ALPHA BANK A.E.-TIRANA BRANCH"
ALPHA BANK A.E.
TIRANA BRANCH (N.K/020)
ANDREAS GALATOULAS


ORFEA DHUCI



Llogaritja e rezultatit financiar per vitin ushtrimor 2005

	ne leke	(ne euro me kurs 122.58)
Fitimi broto sipas librave kontabel	1,048,535,752.29	
Shpenzime te pa zbritshme	15,618,018	
Fitimi i tatueshem neto	1,064,153,770.29	
Norma e tatim fitimit ne %	23%	
Tatim fitimi per tu paguar	244,755,367	
Tatim fitimi i parapaguar	236,361,069	
Diference per tu paguar	8,394,298	
Fitimi pas pagimit te taksave	803,780,385	6,557,190.28
Krijimi i rezervave statutore	160,756,077	1,311,438.06
Fitimi neto i vitit ushtrimor	643,024,308	5,245,752.23

ALPHA BANK A.E.
TIRANA BRANCH (M.K 020)


O.DHUCI


I.PRIFTI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr 1726 Rep.



STUDIO NOTERIE
MALLKUCI & SADUSHAJ

VERTETIM


Sot me date 17.3 2007, para meje Arjana R. Mallkuci, notere ne qytetin Tirane, me zyre ne Rr. "Vaso Pasha", Pall. 13/1, u paraqit personalisht,


Albem Ilir Bello, lindur me 04.08.1980, me banim ne Tirane, me dokument

identifikimi nr. 1 rrojcur, i/e cili me paraqiti origjinalin e dokumentit curatorim eks. perh
kontobel date 21.07.2005 nr. 3507/1 prot ngr Bankes shqiperise

dhe une noterja vertetoj se fotokopja eshte e njejte me origjinalin.

NOTERE


Arjana R. MALLKUCI



01/08/05



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË**

Sheshi "Skënderbej", No. 1, Tirana - Albania • Tel: ++355 4 222230; 222750; 235568
• Fax: ++355 4 223558 • Website: www.bankofalbania.org • E-mail: public@bankofalbania.org

**DEPARTAMENTI I MBIKËQYRJES
SEKTORI I LICENCIMIT DHE RREGULLIMEVE BANKARE**
Nr. 3507 / Prot.

Handwritten notes:
M
Laba
Rept

Tirane, me 21.02.2005

Për: DEGEN E BANKES ALFA
TIRANE

Lënda: Miratimi i ekspertit kontabël të autorizuar për vitin 2005 – KPMG Albania sh.p.k.

I nderuar zoti Drejtor
BANKA E SHQIPËRISË, mori në shqyrtim kërkesën dhe dokumentacionin përkatës, paraqitur nga ana juaj me shkresën nr. 3431 prot., datë 13.07.2005 "Për emërimin e ekspertit kontabel të autorizuar për kontrollin e raporteve financiare të vitit 2005" – shoqëria KPMG Albania sh.p.k. Mbështetur në kërkesat e rregullores "Për ekspertët kontabël të autorizuar të bankave", miratuar me vendimin Nr. 06, datë 29.01.2003 dhe ndryshuar me vendimin nr.102, datë 10.12.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, Banka e Shqipërisë

Jep miratimin për emërimin e shoqërise audituese KPMG Albania sh.p.k., për të bërë auditimin e Deges se Bankës Alfa, Tirane për vitin 2005.

Me respekt
Klodion SHEHU
DREJTOR






ALPHA BANK A.E. –TIRANA BRANCH

**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më
31 Dhjetor 2005**

(dhe raporti i ekspertit kontabël të autorizuar)



Përmbajtja

Raporti i ekspertit kontabël të autorizuar	1
Pasqyra e të ardhura – shpenzimeve	2
Bilanci Kontabël	3
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	4
Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare	5
Shënime të pasqyrave financiare	
1. Përshkrim i përgjithshëm	6
2. Përmbledhje e parimeve bazë kontabël	6
3. Të ardhurat nga interesat	9
4. Shpenzimet për interesat	9
5. Të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet	9
6. Rezultati neto nga këmbimet valutore	10
7. Shpenzime personelit	10
8. Shpenzime qerasë	10
9. Furnitura dhe shërbime	10
10. Shpenzime të tjera operative	11
11. Tatimi mbi fitimin	11
12. Mjetet monetare dhe llogaritë me Bankën Qëndrore	12
13. Hua dhe paradhënie bankave	12
14. Hua dhe paradhënie klientëve	13
15. Letra me vlerë – investimi	15
16. Mjete të tjera	15
17. Mjete të qëndrueshme të trupëzuara	16
18. Mjete të qëndrueshme të patrupëzuara	16
19. Hua dhe paradhënie nga bankat	17
20. Detyrime ndaj klientëve	17
21. Detyrime të tjera	18
22. Kapitali i paguar	19
23. Diferenca nga rivlerësimi	19
24. Fonde të tjera Rezervë	19
25. Transaksionet me palët e lidhura	19
26. Angazhime financimi dhe zëra të tjera jashte Bilancit	20
27. Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to	21
28. Administrimi i riskut financiar	22
29. Pasqyrimi në vlerë venale	27
30. Ngjarjet pas mbylljes së Bilancit	27

INFORMACION I PERGJITHSHEM



Zyra e Qëndrore

Bulevardi "Zogu I" 47
Tiranë

Përfaqësuesit ligjorë

Kalo & Associates
Rr. Kavajes
Tirana Tower, #59

Raporti i auditorëve të pavarur

Pronarëve të Alpha Bank A.E., Tirana Branch

Tiranë, 30 Mars 2006

Ne kemi audituar bilancin kontabël bashkëlidhur të Alpha Bank A.E., Tirana Branch ("Banka") për ushtrimin e mbyllur me datë 31 Dhjetor 2005 dhe pasqyrat përkatëse të të ardhurave, ndryshimet e kapitalit dhe të fluksit të parasë për fundin e vitit. Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare është përgjegjësi e Drejtuesve të Bankës. Përgjegjësia jone është që, bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare.

Ne e kryem auditimin tonë në pajtim me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që të planifikohet dhe të kryhet auditimi për të marrë sigurinë e arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale. Auditimi përfshin ekzaminimin, mbi bazën e testeve, të evidencës që mbështet shumat dhe informacionet e dhëna në pasqyrat financiare. Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e parimeve kontabël të përdorura dhe të cmuarjeve të rëndësishme të bëra nga Drejtuesit, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare. Ne besojmë se auditimi jep një bazë të arsyeshme për opinionin tonë.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë për gjendjen financiare të Bankës me datë 31 Dhjetor 2005, për rezultatet e veprimtarive të saj dhe flukset e parasë për ushtrimin e mbyllur, në pajtim me Neni 38 të ligjit për Bankat në Republikën e Shqipërisë.

*KPMG Albania Sh.p.k.*KPMG Albania Sh.p.k.
Dëshmoret e 4 Shkurtit Str.
Tirana
Albania**KPMG Albania Sh.p.k.**Initialled for purposes
of identification
KPMG

ALPHA BANK A.E. – TIRANA BRANCH

PASQYRA E TE ARDHURA - SHPENZIMEVE
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2005)

(në mijë Lekë)

	Shënime	31 Dhjetor 2005	31 Dhjetor 2004
Të ardhura nga interesat	3	1,653,379	1,311,099
Shpenzime për interesat	4	(512,475)	(519,617)
Të ardhura neto nga interesat		1,140,904	791,482
Të ardhura neto nga komisionet	5	158,235	139,828
Rezultati neto nga këmbimet valutore	6	64,583	78,174
Të ardhura të tjera operative		638	48
TE ARDHURA OPERATIVE		1,364,360	1,009,532
Shpenzime personeli	7	(92,435)	(83,657)
Shpenzime qeraje	8	(53,479)	(39,759)
Furnitura dhe shërbime	9	(137,187)	(92,303)
Shpenzime të tjera operative	10	(83,709)	(29,825)
Kthime/Provigjine për humbje nga kreditë	14	50,985	(253,038)
SHPENZIME OPERATIVE		(315,825)	(498,582)
FITIMI (HUMBJA) PARA TATIMIT		1,048,535	510,950
Tatimi mbi fitimin	11	(244,755)	(136,389)
FITIMI (HUMBJA) NETO PER VITIN		803,780	374,561

Pasqyrat financiare të Bankës u publikuan më 24 Shkurt 2006.

Andreas GALATOULAS
 MANAGER

Orfea DHUÇI
 ASS. MANAGER

ALPHA BANK A.E. – TIRANA BRANCH

PASQYRA E TE ARDHURA - SHPENZIMEVE
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2005)

(në mijë Lekë)

	Shënime	31 Dhjetor 2005	31 Dhjetor 2004
Të ardhura nga interesat	3	1,653,379	1,311,099
Shpenzime për interesat	4	(512,475)	(519,617)
Të ardhura neto nga interesat		1,140,904	791,482
Të ardhura neto nga komisionet	5	158,235	139,828
Rezultati neto nga këmbimet valutore	6	64,583	78,174
Të ardhura të tjera operative		638	48
TE ARDHURA OPERATIVE		1,364,360	1,009,532
Shpenzime personeli	7	(92,435)	(83,657)
Shpenzime qeraje	8	(53,479)	(39,759)
Furnitura dhe shërbime	9	(137,187)	(92,303)
Shpenzime të tjera operative	10	(83,709)	(29,825)
Rimarrje/Provigjone për humbje nga huatë	14	50,985	(253,038)
SHPENZIME OPERATIVE		(315,825)	(498,582)
FITIMI PARA TATIMIT		1,048,535	510,950
Tatimi mbi fitimin	11	(244,755)	(136,389)
FITIMI NETO PER VITIN		803,780	374,561

Keto Pasqyra financiare jane aprovuar nga Drejtuesit e Alpha Bank A.E., Tirana Branch me 24 Shkurt 2006 dhe te nenshkruara ne emer te tyre nga:

Andreas GALATOULAS
 MANAGER

Orfea DHUCI
 ASS. MANAGER

ALPHA BANK A.E. – TIRANA BRANCH**BILANCI KONTABEL****Më 31 Dhjetor 2005***(në mijë Lekë)*

	<i>Shënime</i>	<i>31 Dhjetor 2005</i>	<i>31 Dhjetor 2004</i>
AKTIVET			
Arka dhe Llogaritë me Bankën Qendrore	12	3,253,055	2,606,566
Hua dhe paradhënie bankave	13	4,920,544	8,120,951
Hua dhe paradhënie klientëve	14	13,210,263	9,860,082
Letra me vlerë – investimi	15	6,697,949	7,147,125
Mjete të tjera	16	79,884	136,887
Mjete të qëndrueshme të trupëzuara	17	351,119	324,937
Mjete të qëndrueshme të patrupëzuara	18	52,934	8,478
Totali i Aktiveve		28,565,748	28,205,026
DETYRIMET			
Hua dhe paradhënie nga bankat	19	2,792,930	6,895,438
Detyrime ndaj klientëve	20	21,790,576	18,307,358
Detyrime të tjera	21	407,280	1,210,262
Fonde rezervë për rrezikun statistikor për mbulimin e humbjeve nga huatë standarte dhe në ndjekje	14	132,058	98,514
Totali i Detyrimeve		25,122,844	26,511,572
KAPITALI AKSIONER			
Kapitali i paguar	22	2,598,378	1,437,052
Diferenca nga rivlerësimi	23	(435,513)	(519,506)
Fonde të tjera reserve	24	476,259	401,347
Fitimi i vitit ushtrimor		803,780	374,561
Totali i Kapitalit Aksioner		3,442,904	1,693,454
Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit Aksioner		28,565,748	28,205,026

ALPHA BANK A.E. – TIRANA BRANCH

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2005

(në mijë Lekë)

	<i>Kapitali i paguar</i>	<i>Diferencan nga rivlerësimi</i>	<i>Rezerva të tjera</i>	<i>Fitimi i akumuluar</i>	<i>Totali</i>
Më 1 Janar 2004	1,437,052	(353,639)	224,264	504,789	1,812,466
Ndryshime në rezervën e rivlerësimit	-	(165,867)	-	-	(165,867)
Kalime tek fondet rezerve	-	-	177,083	(177,083)	-
Shperndarja e fitimit	-	-	-	(327,706)	(327,706)
Fitimi neto për vitin	-	-	-	374,561	374,561
Më 31 Dhjetor 2004	1,437,052	(519,506)	401,347	374,561	1,693,454
Kthimi i detyrimit ndaj Alpha Bank A.E. Athine në Kapital Aksioner	861,677	-	-	-	861,677
Ndryshime në rezervën e rivlerësimit	-	83,993	-	-	83,993
Kalime tek fondet rezerve	-	-	74,912	(74,912)	-
Shperndarja e fitimit tek Kapitali i paguar	299,649	-	-	(299,649)	-
Fitimi neto për vitin	-	-	-	803,780	803,780
Më 31 Dhjetor 2005	2,598,378	(435,513)	476,259	803,780	3,442,904

PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2005

(në mijë Lekë)

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2005	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2004
Fluksi i mjeteve monetare nga aktivitetet operative		
Fitimi (Humbja) para tatimit	1,048,536	510,950
<i>Korrigjime për:</i>		
Shpenzime për interesa	512,475	519,617
Të ardhurat nga interesat	(1,653,379)	(1,311,099)
Ndryshimet në diferencat nga rivlerësimi	83,993	(169,508)
Zhvlërësimi dhe amortizimi	48,731	4,243
Efekti i rivlerësimit të detyrimeve në valutë	(29,494)	-
Rimarrje e provigjoneve / (shpenzim) për provigjone	(50,986)	253,037
Humbja operative para ndryshimeve në kapitalin qarkullues:	(40,124)	(192,760)
Rritje / (pakësim) në huatë dhe paradhëniet për klientët	(3,204,339)	2,829,249
Pakësim në llogari të arkëtueshme	57,003	273,669
Pakësim në huatë dhe paradhëniet për Institucionet e Kreditit	(4,102,508)	(2,661,983)
Rritje në depozitat e klientëve	3,477,829	3,079,117
Rritje / (pakësim) në detyrime të tjera	79,794	(113,212)
Pagimi i tatimit mbi fitimin	(236,361)	(170,197)
Fluksi neto nga aktivitetet operative	(2,883,725)	3,811,051
Fluksi i mjeteve monetare nga aktivitet investuese		
Blerje të mjeteve të qendrueshme	(119,369)	(23,537)
Zvogelim / (Rritje) në blerje të letrave me vlerë të investimit	449,176	(4,177,974)
Fluksi neto nga aktivitetet investuese	329,807	(4,201,511)
Fluksi i mjeteve monetare nga aktivitetet financuese		
Pakësim i detyrimeve me Qendren për fitimin e akumuluar	(861,677)	-
Rritje e kapitalit aksioner	861,677	-
Fluksi neto nga aktivitetet financuese	-	-
Rritja / (pakësimi) neto në mjetet monetare dhe ekuivalente	(2,553,918)	(390,460)
Mjetet monetare dhe ekuivalente me të më 1 Janar	10,727,517	11,117,977
Mjetet monetare dhe ekuivalente me të më 31 Dhjetor (shiko shënimin 27)	8,173,599	10,727,517

ALPHA BANK A.E. – TIRANA BRANCH

Shënime të pasqyrës financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2005

(në mijë Lekë, përveç se kur shprehet ndryshe)

1. Përshkrim i përgjithshëm

Alpha Bank A.E., Tirana Branch ("Banka") u themelua më 1998 si degë Alpha Bank A.E., Athinë, e cila është Kompania mëmë e Alpha Bank Group. Zyrat qendrore të Bankës ndodhen tek Blvd. "Zogu I" No. 47, Tiranë, Shqipëri.

Banka është regjistruar si degë e Alpha Bank A.E., Athinë ("Kompania mëmë"), dhe është licencuar për të kryer aktivitete që lidhen me transfertat, kreditë dhe depozitat, si dhe aktivitete të tjera të parashtruara në ligjin "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë" (No. 8365 miratuar më 2 Korrik 1998) dhe ligjin "Mbi Bankën e Shqipërisë" (No. 8269 miratuar më 23 Dhjetor 1997).

Gjatë vitit 2005, Banka ka zgjeruar aktivitetin e saj duke hapur një degë të re në Tiranë. Aktualisht Banka ka 8 (tetë) degë të shtrira në 7 (shtatë) rrethe të ndryshme të vendit (2 dy ndër të cilat ndodhen në Tiranë, dhe të tjerat në Durrës, Elbasan, Berat, Gjirokastrë, Vlorë, and Fier) si dhe një Agjensi në Kakavijë.

Më 31 Dhjetor 2005, Bank kishte 85 punonjës (më 31 Dhjetor 2004: 68 punonjës).

2. Përmbledhje e parimeve bazë kontabël

(a) Baza e përgatitjes së Pasqyrave Financiare

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me Nenin 38 të ligjit "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", No. 8365, miratuar më 2 Korrik 1998.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazen e kostos historike. Te dhenat aktuale dhe ato krahasuese janë shprehur në mijë lekë, përveç se kur shprehet ndryshe.

(b) Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjete monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë bankënotat dhe monedhat metalike në arkë si dhe të gjitha mjetet monetare të depozituara në Bankën Qendrore përveç reserves së detyrueshme, si dhe investime afatshkurta likuide me maturitet nën tre muaj.

(c) Letra me vlerë investimit

Letrat me vlete të investimit përfshijnë Bonot e Thesarit. Bonot e Thesarit paraqiten në Bilanc me vlerë nominale duke zbritur diskauntin e perllogaritur. Bonot e Thesarit janë klasifikuar si investime deri në maturimin pasi Banka ka për qëllim dhe është e aftë të mbajë të investuara në Bono Thesari mjetet e saj deri në maturimin e tyre.

Kur Bonot fitojnë interes të fshehur (implicit), llogaritet norma efektive e interesit dhe interesi i perllogaritur.

ALPHA BANK A.E. – TIRANA BRANCH

Shënime të pasqyrës financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2005

(në mijë Lekë, përveç se kur shprehet ndryshe)

2. Përmbledhje e parimeve bazë kontabël (vazhdimi)

(d) Hua dhe paradhënie klientëve

Huatë dhe paradhëniet e dhëna klientëve paraqiten në vlerë bruto. Rezerva për humbjet potenciale nga huatë regjistrohet në Bilanc si detyrim i Bankës.

Politika huadhënëse e Bankës është në përputhje me ligjet në fuqi (Ligji No. 8365, Korrik 1998 dhe ligji “Mbi administrimin e riskut të kredisë” No. 52, Korrik 2004). Banka i klasifikon portofolin e huasë në pesë kategori duke aplikuar normat e mëposhtme për krijimin e fondeve rezervë:

Tipi i huasë	Ditë vonesat	Fondi rezervë
Standarte	0-30 days	1%
Në ndjekje	31-90 days	5%
Nën standarte	91-180 days	20%
E dyshimte	181-365 days	50%
E humbur	Over 365 days	100%

Huatë dhe paradhëniet që bëjnë pjesë në tre kategoritë e fundit paraqiten në Bilanc duke zbritur fondin rezervë për humbje nga vlera bruto e tyre. Ndërsa huatë që bëjnë pjesë në dy kategoritë e para paraqiten në Bilanc me vlerën e tyre bruto. Për to llogaritet rezerva për rrezikun statistikor të humbjes e cila paraqitet në Bilanc si detyrim.

(e) Mjete të qëndrueshme të trupëzuara

Mjetet e qëndrueshme të trupëzuara paraqiten duke zbritur zhvlerësimin e akumuluar nga vlera e tyre bruto. Përlllogaritja e amortizimit bëhet me metodën lineare.

Normat vjetore të zvlerësimit/amortizimit vijojnë si më poshtë:

Pershkrimi	Norma vjetore e amortizimit
Përmirësimet e objekteve të marra me qera	5%
Makineri dhe pajisje	20%
Pajisje elektronike	25%
Pajisje dhe instalime	20%

(f) Përmirësimet e objekteve të marra me qera

Përmirësimet e objekteve të marra me qera paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar. Përlllogaritja e amortizimit bëhet në mënyrë lineare përgjatë periudhës së qerasë.

Me rregullore të Bankës së Shqipërisë vlera neto e përmirësimeve të objekteve të marrë me qera paraqitet në Bilanc në zërin « mjete të tjera ».

ALPHA BANK A.E. – TIRANA BRANCH

Shënime të pasqyrës financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2005

(në mijë Lekë, përveç se kur shprehet ndryshe)

2. Përmbledhje e parimeve bazë kontabël (vazhdimi)

(g) Mjete të qëndrueshme të patrupëzura

Mjetet fikse të patrupëzuara të blera nga Banka, paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar. Normat vjetore të amortizimit vijnë si më poshtë:

Programe kompjuterike 25%

(h) Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve bëhet mbi bazën e parimit të të drejtave të konstatuara, përveç se kur huatë klasifikohen në si nënstandarte, të dyshimta dhe të humbura. Në këtë rast njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve bëhet mbi bazën e parimit monetar.

Për shërbimet financiare që kryen Banka (si manaxhimi i fondeve, shërbimet e brokerimi dhe këshilla për investime) aplikohen komisione. Të ardhurat nga komisionet njihen kur kryhet shërbimi përkatës.

(i) Tatimi mbi fitimin

Banka llogarit tatimin mbi fitimin në fund të vitit duke u bazuar në legjislacionin shqiptar mbi taksat. Në vitin 2004, tatimi mbi fitimin është llogaritur si 23% i fitimit të tatueshem. Fitimi i tatueshem llogaritet duke rregulluar fitimin perpara taksave me disa zëra të ardhurash ose shpenzimesh që konsiderohen të pazbritshme bazuar në kërkesat e ligjit. (Detajet jepen në shënimin 11).

(j) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në atë vendase sipas kursit të këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj, të deklaruara me kosto historike, konvertohen sipas normës së këmbimit të fundvitit. Diferencat nga konvertimi paraqiten në pasqyrën e të ardhurave - shpenzimeve. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj, të deklaruara me kosto historike konvertohen sipas normës së këmbimit në datën e transaksionit, përveç zërit "Mjete të qëndrueshme" që konvertohen me kursin e këmbimit të fund vitit.

Kurset e këmbimit të monedhave të huaja kundrejt lekut për monedhat kryesore në datën 31 Dhjetor 2005 dhe 2004 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2005	31 Dhjetor 2004
USD	103.58	92.64
EUR	122.58	126.35
CHF	78.86	81.87
GBP	178.65	178.69

(k) Informacion krahasues

Informacioni krahasues është paraqitur në mënyrë konsistent duke aplikuar politikat kontabile të Bankës. Kur është parë e nevojshme informacioni krahasues është ri-klasifikuar për qëllime krahasuesmerie.

ALPHA BANK A.E. – TIRANA BRANCH

Shënime të pasqyrës financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2005

(në mijë Lekë, përveç se kur shprehet ndryshe)

3. Të ardhurat nga interesat

Të ardhurat nga interesat detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2005	31 Dhjetor 2004
Hua dhe paradhënie per klientët	943,601	677,914
Letra me vlerë me të ardhura fikse	504,898	455,355
Hua dhe paradhënie bankave	135,271	118,577
Interesa nga rezerva e detyrueshme	52,145	43,894
Të tjera	17,464	15,359
Totali i të ardhurave nga interesat	1,653,379	1,311,099

4. Shpenzime për interesat

Shpenzimet për interesat detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2005	31 Dhjetor 2004
Depozitat e klientëve	472,895	488,453
Hua dhe paradhënie nga bankat	38,668	26,895
Të tjera	912	4,269
Totali i shpenzimeve për interesat	512,475	519,617

5. Të ardhura neto nga komisionet

Të ardhurat neto nga komisionet përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2005		31 Dhjetor 2004	
	<u>Të ardhura</u>	<u>Shpenzime</u>	<u>Të ardhura</u>	<u>Shpenzime</u>
Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare	400	(3,902)	1,134	(3,984)
Mirëmbajtje llogarie	5,815		7,752	
Transfertat e parave	9,711		14,694	
Telex-swift	25,503		24,373	
Komisioni e huave	42,019		30,227	
Komisionet e shërbimeve	80,283	(1,594)	67,044	(1,412)
Totali	163,731	(5,496)	145,224	(5,396)
Të ardhura neto nga komisionet	158,235		139,828	

ALPHA BANK A.E. – TIRANA BRANCH**Shënime të pasqyrës financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2005***(në mijë Lekë, përveç se kur shprehet ndryshe)***6. Rezultati neto nga këmbimet valutore**

Rezultati neto nga këmbimet valutore detajohet si më poshtë:

	<i>31 Dhjetor 2005</i>	<i>31 Dhjetor 2004</i>
Fitim nga këmbimet valutore	484,174	648,327
Humbje nga këmbimet valutore	(419,591)	(570,153)
Rezultati neto nga këmbimet valutore	64,583	78,174

7. Shpenzime personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë:

	<i>31 Dhjetor 2005</i>	<i>31 Dhjetor 2004</i>
Pagat	71,152	70,479
Pagesa për punën jashtë orarit	953	-
Shpërblime	3,640	-
Shpenzime për dieta	1,034	130
Shpenzime për sigurime shoqërore	13,682	11,264
Të tjera	1,974	1,784
Totali i shpenzimeve të personelit	92,435	83,657

8. Shpenzime qeraje

Banka ka kontrata qeraje për zyrat në territorin e Shqipërisë. Shpenzimet e qerasë që lindin nga detyrimet kontraktore për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2005 janë 53,479 mijë Lekë (31 Dhjetor 2004: 39,759 mijë Lekë).

9. Furnitura dhe shërbime

Zëri furnitura dhe shërbime detajohen si më poshtë:

	<i>31 Dhjetor 2005</i>	<i>31 Dhjetor 2004</i>
Telefon dhe electricite	59,859	47,862
Materiale zyre	24,821	12,489
Shpenzime për sigurinë	8,301	7,920
Udhëtime pune dhe të tjera	11,297	5,678
Argëtim dhe publicitet	5,667	2,935
Shërbime ligjore dhe konsulence	4,447	3,869
Shërbime mirëmbajtje	18,848	7,571
Sigurimi	739	351
Shërbime të tjera	3,208	3,628
Totali i furniture dhe shërbime	137,187	92,303

ALPHA BANK A.E. – TIRANA BRANCH**Shënime të pasqyrës financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2005***(në mijë Lekë, përveç se kur shprehet ndryshe)***10. Shpenzime të tjera operative**

Shpenzime të tjera operative detajohen si më poshtë:

	<i>31 Dhjetor 2005</i>	<i>31 Dhjetor 2004</i>
Primi i sigurimit të depozitave	34,227	26,539
Zhvlerësim dhe amortizim	48,731	3,286
Të tjera	751	-
Shpenzime të tjera operative	83,709	29,825

11. Tatimi mbi fitimin

Për vitin 2005, norma tatimit mbi fitimin është 23% (2004: 25%).

Më poshtë paraqitet kuadrimi i fitimit kontabël në përputhje me Standardet Kombëtare të Raportimit Financiar me fitimin e tatueshëm:

	<i>31 Dhjetor 2005</i>	<i>31 Dhjetor 2004</i>
Fitimi kontabël para tatimit	1,048,535	510,950
<i>Diferenca të përhershme:</i>		
Shpenzime të pazbritshme nga fitimi për qëllime tatimi	15,618	34,606
Fitimi i tatueshëm	1,064,153	545,556
Norma e tatimit @ 23%	244,755	136,389

Kuadrimi i tatimit për vitet që u mbyllën më 31 Dhjetor 2005 dhe 31 Dhjetor 2004 vijon si më poshtë:

	<i>31 December 2005</i>	<i>31 December 2004</i>
Më 1 Janar	63,611	29,803
Parapagime gjatë vitit	172,750	170,197
Shpenzimi për tatimin	(244,755)	(136,389)
Totali (shiko shënimin 21)	(8,394)	63,611

ALPHA BANK A.E. – TIRANA BRANCH

Shënime të pasqyrës financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2005

(në mijë Lekë, përveç se kur shprehet ndryshe)

12. Arka dhe llogaritë me Bankën Qëndrore

Arka dhe llogaritë me Bankën Qëndrore përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2005	31 Dhjetor 2004
Arka:		
- në Lekë	810,965	610,907
- në monedhë të huaj	190,770	129,246
Llogaritë me Bankën Qëndrore:	620,195	481,661
- Llogari rrjedhëse	2,442,090	1,731,643
- Depozitat	111,394	13,397
- Rezerva e detyrueshme	400,071	264,016
	1,930,625	1,718,246
Totali	3,253,055	2,606,566

Në përputhje me kërkesat e Bankës së Shqipërisë, bankat mbajnë në Bankën e Shqipërisë një rezervë në masën 10% të depozitave të klienteve si rezervë të detyrueshme.

Normat mesatare të interesit të aplikuara mbi rezervën e detyrueshme vijojnë si më poshtë:

- Balancat në Lekë: 70% e Yeld-it të marrëveshjeve të riblerjes: 2.97% (vjetore) më 31 Dhjetor 2005 (31 Dhjetor 2004: 3.67%);
- Balancat në USD: 70% e Yeld-it të marrëveshjeve të riblerjes: 1.92% më 31 Dhjetor 2005 (31 Dhjetor 2004: 1.69%); dhe
- Balancat në EUR: 70% e Yeld-it të marrëveshjeve të riblerjes: 1.28% më 31 Dhjetor 2005 (31 Dhjetor 2004: 1.52%).

Llogaritë rrjedhëse me me Bankën Qëndrore nuk fitojnë interes.

13. Hua dhe paradhënie bankave

Huatë dhe paradhënie bankave vijojnë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2005	31 Dhjetor 2004
Llogaritë rrjedhëse		
- Rezident	60,837	21,356
- Jo-rezident	18,216	14,524
	42,621	6,832
Depozita me afat:		
- në Lekë (Bankat Rezidente)	4,859,707	8,099,595
- në monedhë të huaj (Bankat Rezidente)	50,000	350,000
- në monedhë të huaj (Bankat jo-rezidente)	351,016	25,014
	4,457,765	7,722,926
Interesi i përlllogaritur	926	1,655
Totali	4,920,544	8,120,951

Balanca e llogarive rrjedhëse në bankat korespondente jo-reziente, 42,621 mijë Lekë (31 Dhjetor 2004: 8,381 mijë Lekë) është e gjitha me Alpha Bank A.E., Athens.

ALPHA BANK A.E. – TIRANA BRANCH

Shënime të pasqyrës financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2005

(në mijë Lekë, përveç se kur shprehet ndryshe)

13. Hua dhe paradhënie bankave (vazhdim)

Normat vjetore të interesit për vendosjet me bankat variojnë si më poshtë :

- Depozitat në Lekë: nga 2.0% në 6.0% (2004: nga 3.5% në 6.7%);
- Depozitat në EUR: nga 1.80% në 2.09% (2004: nga 1.7% në 2.3%);
- Depozitat në USD: nga 2.30% në 3.79% (2004: nga 0.69% në 2.3%);
- Depozitat në GBP: nga 4.50% në 4.78% (2004: nga 3.6% në 4.76%);

Më 31 Dhjetor 2005, vendosjet në monedhë të huaj (EUR, USD and GBP), ekuivalente me 1,647,389 mijë Lekë janë depozituar tek Alpha Bank A.E., Athens (31 Dhjetor 2004: 1,086,856 mijë Lekë).

14. Hua dhe paradhënie klientëve

Hua dhe paradhënie dhënë personave juridik dhe fizik përdhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2005	31 Dhjetor 2004
Overdrafte	1,522,157	1,094,923
Hua	11,807,130	9,102,069
Interesi i përllogaritur	98,888	37,577
Rezerva për humbje nga kreditë	(217,912)	(374,487)
Totali	13,210,263	9,860,082

Huatë dhe paradhënie klientëve sipas afatit të maturimit më 31 Dhjetor 2005 dhe 31 Dhjetor 2004 vijon si më poshtë:

	31 Dhjetor 2005	31 Dhjetor 2004
Overdrafte	1,522,157	1,094,923
Hua afatshkurtra	3,694,510	3,837,415
Hua afatmesme	1,095,796	1,589,233
Hua afatgjata	7,016,824	3,675,420
Totali i huave bruto	13,329,287	10,196,991

Huate afatshkurtra kanë maturim deri në një vit, huatë afatmesme kanë maturim nga një në pesë vjet, dhe huatë afatgjata kanë maturim mbi pesë vjet.

